

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5520
E shtunë, 7 korrik 2018
çmimi 0.40 €

Kuvendi zgjedh tre gjyqtarët e Kushtetueses

Deputetët e Kuvendit të Kosovës në seancën e së premtes kanë zgjedhur tre anëtarët e Gjykatës Kushtetuese: Remzije Istrefi-Pecin, Nexhmi Rexhepin dhe Safet Hoxhën. Këta tre emra tashmë i kanë shkuar për dekretim presidentit Hashim Thaçi ■ F. 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

PROBLEME THEMELORE TË PUNIMEVE STUDIMORE (3)

F. 11

Hajdin ABAZI



DELAWIE, I SHOETËSUAR ME KËRCËNIMET NDAJ PJESËTARËVE SERBË TË FSK-SË

F. 5

MË 9 KORRIK HAPET KONKURSI PËR PRANIMIN E STUDENTËVE NË UP

F. 6

EKONOMI

BANKA BOTËRORE APROVON PROJEKTIN E EKONOMISË DIGJITALE PËR KOSOVËN

F. 9

QEVERIA MIRATON KONCEPTDOKUMENTET E TRASHËGIMISË KULTURORE

F. 8

KULTURË

QEVERIA MIRATON KONCEPTDOKUMENTET E TRASHËGIMISË KULTURORE

F. 13

SPORT

PASARDHËS I VOKRRIT NË KRYE TË FFK-SË, AGIM ADEMI

F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", HAJDAR BEQA ■ F. 4-5

Thaçi, njeriu i duhur për ta drejtuar dialogun

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hajdar Beqa, ka bërë me dije se koalicioni qeverisës mbështet presidentin Hashim Thaçi për ta përfaqësuar Kosovën në dialog me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Beqa ka pohuar se Thaçi është njeriu më i duhur për ta përfaqësuar Kosovën në bisedimet me Serbinë. Ai ka thënë se për këtë çështje konsensusi kombëtar është i nevojshëm. Beqa ka theksuar se dialogu duhet të vazhdojë pavarësisht nëse e përkrah apo jo opozita. Duke folur për paralajmërimet e opozitës se kjo qeveri i ka ditët e numëruara, deputeti i PDK-së ka thënë se këtë Qeveri mund ta rrëzojë vetëm mazhoranca nëse e sheh se nuk po përmbushen objektivat e parapara. "Sa i përket kësaj opozite, Qeveria mund ta çojë mandatin deri në fund", ka thënë Beqa

Hoti: Kriza institucionale po thellohet

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, në një konferencë për medie mbajtur të premten ka thënë se vendi po hyn në krizë institucionale. Hoti ka thënë se Kuvendi i Kosovës është jofunksional pasi të gjitha seancat e hapura në muajt e fundit nuk janë mbyllur.



Po sipas tij, KQZ-ja është bllokuar nga presidenti, ndërkaq për kryeministrin ka thënë se është duke marrë vendime joligjore ■ F. 7

Mbi 352 mijë ndërtime pa leje në Kosovë

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, duke prezantuar të premten pakon informuese për procedurat e lejeve ndërtimore, ka bërë me dije se deri më tani janë identifikuar mbi 352 000

ndërtime pa leje në Kosovë. Ajo ka thënë se kjo pako informuese krijon një standardizim dhe unifikim të aplikimit, shqyrtimit dhe menaxhimit të kërkesave për leje të ndërtimit nga të gjitha komunat



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Pritren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A.
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Philip Kosnett, ambasador i ri i ShBA-së në Prishtinë

Shtëpia e Bardhë ka bërë me dije të premtën se presidenti Donald Trump ka njoftuar synimin për ta emëruar diplomat Philip S. Kosnett nga Virxhinia, ambasador të jashtëzakonshëm dhe fuqplotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës



WASHINGTON, 6 KORRIK - Presidenti Donald Trump planifikon ta emërojë diplomat Philip S. Kosnett nga Virxhinia, ambasador të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës, ka bërë me dije të premtën Shtëpia e Bardhë. Kosnett aktualisht është i Ngarkuar me Punë i Përkohshëm në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Ankara. Gjatë karrierës së tij në Shërbimin e Jashtëm, ai ka punuar në tetë misione të Shteteve të Bashkuara në Evropë, Azi dhe Lindjen e Mesme si dhe në pozita të larta

drejtuese në Departamentin e Shtetit. Pjesa më e madhe e karrierës së Kosnett ka qenë e fokusuar në bashkëpunimin ndërkombëtar të sigurisë dhe pajtimin politik. Ai ka shërbyer si zëvendësues misioni në Uzbekistan dhe në Islandë, si dhe në pozita politike, politiko-ushtarake dhe ekonomike-tregtare në Afganistan, Irak, Kosovë, Holandë dhe Japoni. Në Uashington ai ka punuar në zyrat e Departamentit të Shtetit për Evropën, kundër-terrorizmit, politiko-ushtarake, të inteligjencës dhe kërkimeve etj. Kosnett është diplomuar në

Universitetin e Harvardit. Ai është nderuar me 10 çmime të Departamentit të Shtetit, ka marrë Medaljen e Zyrës së Sekretarit të Mbrojtjes për Shërbim Civil të

Jashtëzakonshëm dhe Medaljen Departamentit të Këmbësorisë për Shërbim Civil të Shkëlqyer. Kosnett flet katër gjuhë të huaja: turqisht, rusisht, holandisht dhe japonisht.

Kosnett pason ambasadorin Greg Delawie, të cilin më 3 mars të vitit 2015, presidenti i atëhershëm i ShBA-së, Barack Obama, e nominoi ambasador në Kosovë.

Hoxha i kërkon Bundestagut mbështetje për liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 6 KORRIK - Liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës ka qenë tema qendrore e takimit në mes të ministres së Integritimit Evropian në Qeverinë e Kosovës, Dhurata Hoxha dhe kryetarit të Komisionit të Bundestagut gjerman për çështjet e Bashkimit Evropian, Gunther Krichbaum. "Përkrahja e Gjermanisë për Kosovën, në veçanti nga Komisionet e Bundestagut dhe rekomandimet pozitive në Parlamentin Evropian, kanë rëndësi të veçantë për proceset që po kalon vendi", ka deklaruar ministrja Hoxha, thuhet në njoftimin e ministrisë. Sipas njoftimit, Hoxha e ka siguruar përfaqësuesin e Bundestagut, Kirchbaum, se



Kosova nuk do të lejojë që lëvizja e lirë të dëmtohet nga askush. Gjatë vizitës në Gjermani ajo është pritur edhe nga përfaqësues të tjerë të Bundestagut dhe shtetit gjerman, me ç'rast është

diskutuar rreth rekomandimeve që Kosova po i pret nga Komisioni Evropian në lidhje me liberalizimin e vizave, marrë parasysh që Gjermania ka një rol shumë të rëndësishëm.

Bushati: Negociatat, rrugë e gjatë, por do të jemi gati në qershor 2019

TIRANË, 6 KORRIK - Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, është i sigurt se Shqipëria po punon që t'i thellojë reformat, në mënyrë që të jetë gati në qershor 2019 për marrjen e rekomandimit për çeljen e negociatave në BE. Në një intervistë në portalin politik "Euroactiv", Bushati ka thënë se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor është Evropa. Ai ka thënë se Qeveria shqiptare ka nisur punën që tani për të vijuar më vonë për thellimin e reformave. "Ne kemi shumë punë për të bërë në fillim, por dua të theksoj se reformat bëhen për njerëzit tanë, sepse ata meritojnë më shumë. Shqipëria nuk është gati të bashkohet me BE-në nesër. Megjithatë, do të jemi gati për procesin e zgjerimit në qershor 2019". Bushati nënvizoi se programi i reformave të Qeverisë nuk do të ndalet vetëm te sistemi i drejtësisë. "Është Qeveria ajo që i ndjek reformat, jo se BE-ja na e



kërkon atë. Shqiptarët janë të parët që përfitojnë nga programi ynë i reformave. Vendimi i BE-së për hapjen e negociatave ka ardhur si njohje e punës sonë. Ai është një vendimi që u jep përpjekjeve tona inkurajim e energji", tha Bushati. Sipas Bushatit, "një Evropë më e fortë mund të jetë kështu vetëm me një Ballkan Perëndimor më të fortë, më të drejtë, më të qëndrueshëm dhe më demokratik, si një pjesë organike e saj. Takimi i Britanisë në takimin e javës së ardhshme tregon se edhe për ata që po largohen nga Bashkimi Evropian, stabiliteti në juglindje është vendimtar", tha Bushati.

Rama takon homologun kinez

TIRANË, 6 KORRIK - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është takuar në Sofje të Bullgarisë me homologun kinez Li Keqiang. Rama ndodhet në Sofje ku do të zhvillohet samiti, në kuadër të

nismës së Qeverisë kineze të bashkëpunimit me Evropën Qendrore dhe Lindore, e njohur si Nisma 16+1. Mësohet se fokusi i takimit ishte programi i bashkëpunimit mes

dy vendeve dhe projektet konkrete në bujqësi, turizëm, infrastrukturë ujore e portuale dhe kulturë. "Me kryeministrin Li Keqiang në takimin bilateral në kuadrin e Nismës 16+1, ku

diskutoam për programin e bashkëpunimit dhe projektet konkrete në bujqësi, turizëm, infrastrukturë ujore e portuale dhe kulturë", ka shkruar Rama në "Facebook".



Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Haradinaj: Kushtetuta është vija e kuqe në dialog

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije të premten se Kosova në fazën finale të dialogut me Serbinë ka vija të kuqe. Duke folur në një konferencë për media pas mbledhjes së Qeverisë, ai ka treguar se vijë e kuqe në këtë proces është Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Sipas Haradinajt, kushdo që e shkelë aktin më të lartë juridik në vend do të japë përgjegjësi sikurse ka ndodhur deri më tani

t'u ikim shablloneve të zakonshme. S'guxojmë të bëjmë gabime në një situatë si kjo. Besoj se do të ketë ndryshim këto ditë që do të vijnë. Kam dëgjuar sinjale të mira edhe nga LDK-ja dhe PSD-ja, por ende nuk kam biseduar me Albinin për t'i parë pikëpamjet e tij", është shprehur Haradinaj. Ai ka treguar se Kosova i ka të qarta parimet për fazën finale të dialogut. "Nuk ka ndarje, as shkëmbim teritorësh dhe as lëvizje të kufijve Kosovë - Serbi", ka thënë Haradinaj.

Zyra e kryeministrit ka dorëzuar përpara kabinetit qeveritar raportin mbi arritjet dhe sfidat në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit, i cili është dorëzuar në takimin e dytë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit mes Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës nga grupi i veçantë për normalizim. Kryeministri Haradinaj ka thënë se raporti evidenton të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në kuadër të dialogut të zhvilluar në Bruksel me autoritetet e Beogradit si dhe

Qeveria ndan 228 mijë euro për invalidët e luftës

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së premtes ka ndarë 228 mijë euro për rehabilitimin e invalidëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ditë më parë ekzekutivi ka ndarë 300 mijë euro edhe për një kategori tjetër të luftës, atë të veteranëve. Po ashtu, Qeveria ka miratuar Projektligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajshme të komunës. Në këtë mbledhje të kabinetit qeveritar është miratuar edhe vendimi për t'i rekomanduar presidentit të Republikës së Kosovës që ta autorizojë ministrin e

Financave që ta nënshkruajë marrëveshjen ndërkombëtare "Programi mbështetës për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale 'Faza VI'". Qeveria ka miratuar edhe planin e veprimit për zbatimin e Direktivës së Komisionit Evropian për shërbimet në tregun e brendshëm sipas Ligjit për shërbime. Gjithashtu, ministri i Financave ka informuar kabinetin qeveritar për dinamiken e realizimit të buxhetit për vitin 2018. Sipas informatës, të hyrat dhe shpenzimet kanë trend pozitivë dhe premtojnë qëndrueshmëri buxhetore për këtë vit.

hapat e sfidat për realizimin e këtyre marrëveshjeve. Sipas tij, ky raport paraqet tërësinë e të dhënave të pranuar nga ekipet teknike që kanë qenë të përfshira në procesin e dialogut, përkatësisht shpreh gjendjen

aktuale në procesin e dialogut. Raporti do të dërgohet në Kuvendin e Kosovës dhe do të publikohet në mënyrë që të jetë i qasshëm edhe për publikun në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë.

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se Kushtetuta e Kosovës është vija e kuqe në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Në një konferencë për media, pas mbledhjes së Qeverisë, ai ka deklaruar të premten se kushdo që shkelë parimet e vendosura në Kushtetutë do të shkarkohet. "Ju e dini se janë shkarkuar presidentë sepse kanë shkelur Kushtetutën. Ne kemi vija të kuqe, ne i kemi në Kushtetutën e vendit. Jemi të shpallur shtet dhe kemi territor. Nëse dikush del jashtë këtyre, ju e dini, është shkarkuar presidenti dy herë. Unë e kuptoj idenë që të nxjerrim vija të kuqe, që janë parimore, por ne e kemi kontratën nga e cila askush nga ne në Kosovë nuk guxojmë të dalim. Ajo është Kushtetuta e vendit. Konsensusi politik i brendshëm nuk është vetëm t'i mbrojmë vijat, por është ta afirmojmë të drejtën tonë", ka thënë Haradinaj.

Kreu i Qeverisë ka treguar se ka parë sinjale të mira për fazën finale të dialogut nga dy partitë në opozitë, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia Socialdemokrate. Sipas Haradinajt, në këtë fazë të dialogut duhet të përfshihen të gjitha partitë e përfaqësuara në Kuvend dhe shoqëria civile. "Është me rëndësi që kemi paj-

tim institucional. Presidenti, kryeparlamentari, kryeministri, partitë politike në Qeveri, përfshirë edhe Nismën, jemi në konsulta të vazhdueshme të përbashkëta me AKR-në dhe kolegë të tjerë. Unë, po ashtu, kam bërë disa komunikime", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se është në konsulta edhe me opozitën. "Jam në komunikim intensiv me partitë e tjera opozitare. Duhet të shkojmë me kujdes. Kjo është temë kombëtare. Do të jetojmë me efektet e kësaj teme që të gjithë si në pozitë si në opozitë. Ata që sot jetojnë dhe ata që kanë për të lindur nesër. Është me rëndësi



Veseli kërkon nga drejtuesit e komisioneve parlamentare rritje të dinamikës së punës



PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka zhvilluar të premten një takim me kryetarët e komisioneve parlamentare, me të cilët ka diskutuar lidhur me përsheptimin e shqyrtimit dhe procedimit të projektligjeve në procedurë. Duke dhënë një pasqyrë të legjislacionit i cili është në procedurë parlamentare, Veseli

ka bërë me dije se aktualisht në shqyrtim në komisione parlamentare janë 41 projektligje. Kryeparlamentari Veseli ka kërkuar nga drejtuesit e komisioneve rritjen e dinamikës së punës për shqyrtimin e projektligjeve, në mënyrë që Kuvendi t'i kryejë përgjegjësitë kushtetuese sipas ritmeve të parapara, sidomos ato që lidhen me procesin e liberalizimit të

vizave. Veseli ka përmendur Projektligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe atë për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë. Drejtuesit e komisioneve parlamentare, nga ana e tyre, paraqitën të dhëna rreth ecurisë së deritashme të punës për përbushjen e detyrave dhe të obligimeve nga ana e komisioneve që ata drejtojnë.

Flet për "Epokën e re", Hajdar Beqa

Thaçi, njeriu i duhur për ta d



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hajdar Beqa, ka bërë me dije se koalicioni qeverisës mbështet presidentin Hashim Thaçi për ta përfaqësuar Kosovën në dialog me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Beqa ka pohuar se Thaçi është njeriu më i duhur për ta përfaqësuar Kosovën në bisedimet me Serbinë. Ai ka thënë se për këtë çështje konsensusi kombëtar është i nevojshëm. Beqa ka theksuar se dialogu duhet të vazhdojë pavarësisht nëse e përkrah apo jo opozita. Duke folur për paralajmërimet e opozitës se kjo qeveri i ka ditët e numëruara, deputeti i PDK-së ka thënë se këtë qeveri mund ta rrëzojë vetëm mazhoranca nëse e sheh se nuk po përmbushen objektivat e parapara. "Sa i përket kësaj opozite, Qeveria mund ta çojë mandatin deri në fund", ka thënë Beqa

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 6 KORRIK - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hajdar Beqa, ka thënë të premten se presidenti Hashim Thaçi është njeriu i duhur për ta udhëhequr fazën finale të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se arritja e konsensusit për këtë proces është i nevojshëm

megjithatë, sipas Beqës, bisedimet do të vazhdojnë me apo pa përkrahjen e opozitës. Ai ka bërë me dije se Kosova tashmë i ka përmbushur obligimet dhe është në pritje të rekomandimit për heqjen e vizave. Sipas Beqës, në variantin më të keq qytetarët do të mund të udhëtojnë pa viza në pjesën e parë të vitit të ardhshëm. Pavarësisht prej sfidave, ai është shprehur i kënaqur me funksionimin e koalicionit qeverisës. "Qeverinë mund ta rrëzojë vetëm

mazhoranca nëse e sheh se nuk po përmbushen objektivat e parapara. Sa i përket opozitës, Qeveria mund ta çojë mandatin deri në fund", ka theksuar ai.

"Epoka e re": Z. Beqa, çfarë vlerësimi keni për funksionimin e koalicionit qeverisës, meqenëse në opinion po duket se ka një zbehje të PDK-së në Qeveri?

Beqa: Pavarësisht prej sfidave, koalicioni qeverisës është funksional. Është duke funk-

sionuar mirë dhe në momente të caktuara po merr vendime të mëdha. Ministrat e PDK-së janë aktivë. Edhe grupi parlamentar është aktiv. Natyrisht se çdoherë ka hapësirë për angazhim dhe punë më të madhe. PDK-ja është shumë aktive dhe ka rolin kryesor si partia më e madhe dhe si bartëse e koalicionit. PDK-ja ka rolin kryesor në koalicion pavarësisht se ka nominuar Haradinajn për kryeministër, i cili e ka pasur dhe vazhdon ta ketë mbështetjen deri në fund të mandatit.

"Epoka e re": Ky funksionim i koalicionit nuk ka reflektuar edhe në punën e Kuvendit i cili ka pasur vështirësi në përmbushjen e agjendës.

Beqa: Kemi pasur pengesa, sidomos kur ka qenë në pyetje demarkacioni me Malin e Zi. Ka pasur raste kur koalicioni ka arritur t'i sigurojë 2/3 e votave, por në raste të caktuara ka munguar shumica e thjeshtë.

Ka pasur raste kur opozita ka bojkotuar procesin e votimit, mirëpo ka pasur raste kur edhe pozita nuk ka qenë aktive. Megjithatë, konsideroj se Kuvendi është duke e kryer detyrën e vet dhe deri në fund të vitit do ta realizojë planin legjislativ për vitin 2018 dhe pritshmëritë.

"Epoka e re": Mosfunksionimi i rregullt i Kuvendit ka ndikuar në ngecjen e agjendës evropiane?

Beqa: Jo, nuk ka ngecje. Të gjitha ligjet që kanë pasur të bëjnë me agjendën evropiane i kemi kaluar me kohë. Në procedurë tashmë janë ligjet për reformat në drejtësi. Komisioni për Legjislacion, në të cilin jam anëtar dhe zëvendëskryetar i parë, është i angazhuar maksimalisht për ta realizuar këtë agjendë. Sa i përket agjendës evropiane i kemi kryer me kohë obligimet tona. Institucionet janë duke e

rejtuar dialogun

t'i kryejmë detyrat tona. Nëse është e nevojshme edhe në kohë të pushimit do të vazhdojmë me angazhime institucionale.

"Epoka e re": *Duke pasur parasysh dallimin e vogël në mes të numrave të pozitës dhe opozitës në Kuvend, sa ka rrezik që kjo Qeveri mos të mund ta çojë deri në fund mandatin?*

Beqa: Qeveria i ka numrat dhe duhet të vazhdojë t'i kryejë detyrat në harmoni me kërkesat e qytetarëve duke realizuar një performancë të mirë në të gjithë sektorët. Deri më tani për çdo vendim të rëndësishëm koalicioni i ka pasur votat falë angazhimit të deputetëve të pozitës dhe të opozitës. Por, nëse opozita i ka numrat për ta rrëzuar Qeverinë, le ta rrëzojë. Është një opozitë e fortë në numra, por e dobët në alternativë.

"Epoka e re": *Kjo opozitë nuk mund ta rrëzojë Qeverinë?*

Beqa: Qeverinë mund ta rrëzojë vetëm mazhoranca nëse e sheh se nuk po përmbushen objektivat e parapara. Sa i përket kësaj opozite, Qeveria mund ta çojë deri në fund mandatin. Aktualisht gjërat janë duke shkuar mirë dhe jemi të interesuar që kjo Qeveri ta çojë mandatin deri në fund. As institucionet dhe as qytetarët nuk e kanë komoditetin për të shkuar çdo gjashtë muaj apo çdo vit në zgjedhje.

"Epoka e re": *Një çështje me të cilën po ballafaqohet vendi është edhe faza finale e dialogut me Serbinë. Koalicioni a mund të sigurojë konsensusin e kërkuar për këtë proces?*

Beqa: Bisedimet po vazhdojnë dhe presidenti Thaçi është duke e përfaqësuar Kosovën në këtë proces dhe kjo e drejtë i takon me Kushtetutë. Mirëpo duhet të arrihet konsensusi në mes të spektrit politik për dialog me Serbinë. Kosovën duhet ta përfaqësojë presidenti dhe është mirë që edhe opozita ta përkrahë atë në këtë proces. Marrëveshjet e arritura në Bruksel duhet të miratohen në Kuvend. Përfundimi sa më i shpejtë i bisedimeve me Serbinë është në interes të dy popujve.

"Epoka e re": *Por opozita nuk po shpreh gatishmëri për t'u bërë pjesë e dialogut. Do të vazhdojë ky proces edhe pa mbështetjen opozitare?*

Beqa: Nuk ka kohë për të na prituri faktori ndërkombëtar

derisa të pajtohet i gjithë populli se kush duhet ta përfaqësojë vendin në bisedime. Kemi ndërtuar institucionet të cilat kanë mandat kushtetues dhe duhet ta përfaqësojnë Kosovën sipas Kushtetutës. Prandaj presidenti Thaçi është njeriu më i duhur për ta përfaqësuar Kosovën në dialogun me Serbinë. Konsensusi është i nevojshëm, por nuk kemi kohë për të humbur. Tri vjet i kemi humbur me demarkacion, po t'i humbim edhe tri vjet me bisedime pasojat do t'i vuajnë qytetarët. Bisedimet duhet të vazhdojnë pavarësisht asaj nëse i përkrah apo jo opozita. Opozita deri tani ka pasur vetëm deklarime politike, por jo alternativë. Thaçi është president dhe bisedimet po zhvillohen në nivel të presidentësh dhe kjo nuk mund të ndryshohet. E përkrahim idenë e konsensusit, por jo të ndërpriten bisedimet. Bisedimet duhet të vazhdojnë deri në arrijten e njohjes reciproke në mes të dy vendeve. Natyrisht se në fund të këtij procesi Kosova do ta ketë një listë me kërkesa për Serbinë e cila ka kryer krime dhe gjenocid në Kosovë.

"Epoka e re": *Para arritjes së marrëveshjes përfundimtare po flitet se do të ketë kompromise të reja në dëm të Kosovës. Kuvendi do të lejojë një gjë të tillë?*

Beqa: Kompromisi kryesor për Kosovën është bërë në bisedimet e Vjenës, pra është Plani i Ahtisarit. Prandaj nuk do të ketë asgjë jashtë Kushtetutës e cila buron nga ky plan.

"Epoka e re": *Mosarritja e konsensusit mund të ketë efekt në prishjen e koalicionit qeverisës?*

Beqa: Koalicioni qeverisës është duke e përkrahur presidentin Thaçi për ta përfaqësuar vendin në dialog me Serbinë. Ndonëse opozita nuk po e përkrah dhe nuk i ka numrat për ta rrëzuar.

"Epoka e re": *Jo i gjithë koalicioni po e mbështet Thaçin. Nisma Socialdemokrate e Fatmir Limajt vazhdon ta kundërshtojë drejtimin e dialogut nga presidenti, madje kjo parti bojkotoi raportimin e tij në Qeveri.*

Beqa: Nuk po flas për partitë e tjera që janë në koalicion, por po flas në tërësi për koalicionin dhe për kryeministrin. Mazhoranca e përkrah Thaçin në këtë proces dhe jemi optimistë se nuk do të jetë ndonjë sfidë për Qeverinë përfaqësimi i presidentit në dialog, përkundrazi do ta forcojë edhe rolin e saj.

Delawie, i shqetësuar me kërcënimet ndaj pjesëtarëve serbë të FSK-së

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Lidhur me kërkesën e pjesëtarëve serbë të Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK) që të lirohen nga kjo forcë, ka reaguar edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Greg Delawie. Nëpërmjet rrjetit social në "Twitter", ambasadori Delawie ka shprehur shqetësimin e thellë për "dorëheqjet e fundit të pjesëtarëve serbë të FSK-së". "Frikësimi nga jashtë i pjesëtarëve të FSK-së është i papranueshëm. Diversiteti i FSK-së është një model për vendin. Ai duhet të kremtohet, e jo të shkatërrohet", ka shkruar Delawie.

Ditët e fundit rreth 20 pjesëtarë serbë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, nga rajoni i Gjilanit, në mënyrë kolektive kanë parashtruar kërkesat për t'u tërhequr nga kjo forcë për shkak të presioneve nga

Beogradi.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se tashmë institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme në lidhje me këto presione që po i detyrojnë pjesëtarët nga komuniteti serb ta braktisin FSK-në. Ky presion është i pakuptimtë, është i dalë kohe sepse këto metoda kanë ndodhur para dhjetë vjetësh dhe jemi të habitur nga kjo qasje. Është shumë e padrejtë sepse dikush po ushtron krim ndaj këtyre qytetarëve të Kosovës, ndaj këtyre të rinjve dhe të rejave, si dhe ndaj familjeve të tyre. Ky presion është kundër konventave, është kundër të drejtave të njeriut, kundër sigurisë së këtyre qytetarëve. Ne si Kosovë kemi vepruar me kohë, duke ndërmarrë veprime si në planin e jashtëm, po ashtu edhe në atë të brendshëm, që të sqarohet ky veprim i papranueshëm", ka deklaruar Haradinaj.



kryer punën dhe i kanë përmbushur të gjitha kërkesat, pavarësisht kushteve të padrejta. Procesi duhet të ecë më shpejt dhe BE-ja duhet ta përkrahë Kosovën në procese integruese si dhe ta rekomandojë liberalizimin e vizave. Megjithatë, Kosovës i mbetet edhe më tutje punë për të bërë. Reforma në drejtësi do të ndikojë në luftimin e krimit dhe korrupsionit.

"Epoka e re": *Ka shanse të shtyhet për një datë të pacaktuar dhënia e rekomandimit për viza?*

Beqa: I kemi përmbushur të gjitha kushtet që të paktën ta fitojmë liberalizimin. Kjo besoj se do të jetë çështje ditësh. Presim që deri në fund të vitit qytetarët të lëvizin pa viza. Në variantin më të keq, kjo mund të vonohet proceduralisht apo teknikisht deri në pjesën e parë të vitit të ardhshëm, respektivisht në muajin janar. Ne do

Ismaili: Ligji për pagat duhet t'i korrigojë padrejtësitë në sektorin e shëndetësisë

PRISHTINË, 6 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka kërkuar nga Qeveria adresimin e kërkesave të tij për ngritje të pagave për punëtorët shëndetësorë. Gjatë diskutimit që është

bërë për Projektligjin për Pagat në mbledhjen e Qeverisë të premten, Ismaili ka thënë se Ligji i ri për pagat duhet t'i korrigojë padrejtësitë në sektorin e shëndetësisë. "Shëndetësia si prioritet

nacional është dhe duhet të konsiderohet politikë e të gjithëve, ndaj kërkoj bashkëpunim nga të gjithë që ky qëllim të arrihet. Kosova ka më së paku mjekë për kokë banori në rajon. Andaj nuk

do të lejoj asnjë pabarazi në trajtim të stafit shëndetësor, aq më pak të pajtohem me fenomenin e ikjes së tyre nga vendi, me rrezikimin që ky sektor me rëndësi kombëtare të mbetet deficitar", ka thënë Ismaili.



Mbi 352 mijë ndërtime pa leje në Kosovë

Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, duke prezantuar të premten pakon informuese për procedurat e lejeve ndërtimore, ka bërë me dije se deri më tani janë identifikuar mbi 352 000 ndërtime pa leje në Kosovë. Ajo ka thënë se kjo pako informuese krijon një standardizim dhe unifikim të aplikimit, shqyrtimit dhe menaxhimit të kërkesave për leje të ndërtimit nga të gjitha komunat



shqyrtimit dhe menaxhimit të kërkesave për leje nga të gjitha komunat. Ajo ka thënë se me anë të këtij standardizimi synohet lehtësimi dhe përshpejtimi i procedurave për pajisje me leje ndërtimi dhe certifikatë për ndërtime të kategorisë 1 dhe 2. Më tutje, ministrja Reshitaj ka shtuar se kjo pako informuese ka për qëllim të ndihmojë në reformat dhe politikat proaktive në fushën e ndërtimit dhe planifikimit hapësinor, të cilat do të ndihmojnë në përshpejtimin e marrjes së lejeve ndërtimore. Reshitaj ka treguar se për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ndër problemet kryesore mbeten ndërtimet pa leje. "Deri më tani

janë identifikuar mbi 352 000 ndërtime pa leje. Aktualisht ndodhemi para aprovimit të ligjit të ri për trajnimin e ndërtimeve pa leje, që i lehtëson procedurat e trajtimit të këtyre ndërtimeve dhe

e ul koston në masë të konsiderueshme", ka deklaruar ministrja Reshitaj.

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 KORRIK - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka bërë të premten prezantimin e pakove informuese për procedurat e lejeve ndërtimore. Në këtë punëtori janë prezantuar të gjitha reformat dhe lehtësirat informuese mbi procedurat për leje ndërtimore dhe të pajisjes me certifikatë për ndërtime të rrezikshmërisë së ulët dhe të mesme.

Ministrja e MMPH-së, Albena Reshitaj, ka theksuar se kjo pako informuese është e rëndësishme, sepse krijon një standardizim dhe unifikim të aplikimit,

Më 9 korrik hapet konkursi për pranimin e studentëve në UP

PRISHTINË, 6 KORRIK - Kandidatët të cilët dëshirojnë të bëhen studentë të nivelit bachelor në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" nga 9 deri më 17 korrik mund të aplikojnë për provimin pranues. Ky vendim është marrë të premten nga Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Provimi pranues do të mbahet sipas njësive akademike të përcaktuara nga fakultetet ndaras. Po ashtu, për provim pranues është

diskutuar edhe numri i kuotave që u jepet aplikuesve. Senati ka vendosur t'u jepet kuotë atyre që aplikojnë nga Presheva dhe Mali i Zi, ndërsa është kërkuar që numri i kuotave të komunitetit pakicë të ulet për shkak se nuk ka studentë për kuotën 12 për qind. Gjithashtu, Senati ka diskutuar edhe për vendet që nuk janë të plotësuara nëpër degë të ndryshme. Është vendosur që vendet të cilat nuk janë të plotësuara të rishpallet konkursi.



Përrurohet sistemi i ri i gjendjes civile

PRISHTINË, 6 KORRIK - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ), kanë përruruar të premten sistemin e ri të gjendjes civile. Tani e tutje qytetarët e Republikës së

Kosovës me vendbanim në Gjermani, Zvicër, Itali, Turqi dhe Arabi Saudite kanë mundësi që faktet e gjendjes civile të ndodhura jashtë vendit, siç janë: lindja, martesat dhe vdekja, t'i regjistrojnë

drejtpërsëdrejti në konsullatë. Me këtë shërbim, shtetasve të Republikës së Kosovës u krijohet lehtësi e madhe për pajisje me dokumente personale siç janë ai për letërnjoftim dhe pasaportë.

Ky sistem nga e premtja fillon të funksionojë në konsullatat e Kosovës, në shtetet e lartcekura, ndërsa pritet në vazhdim të krijohet mundësia teknike dhe ligjore edhe për konsullatat e tjera të Kosovës.



Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka mbajtur konferencë për medie

Hoti: Kriza institucionale po thellohet

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, në një konferencë për medie mbajtur të premten ka thënë se vendi po hyn në një krizë institucionale. Hoti ka thënë se Kuvendi i Kosovës është jofunksional pasi të gjitha seancat e hapura në muajt e fundit nuk janë mbyllur. Po sipas tij, KQZ-ja është bllokuar nga presidenti, ndërsa për kryeministrin ka thënë se është duke marrë vendime jologjore



**EPOKA
ERE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 6 KORRIK - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se është duke u thelluar kriza institucionale në vend si pasojë e qeverisë aktuale. Ai ka thënë se Kuvendi i Kosovës është jofunksional pasi të gjitha seancat e hapura në muajt e fundit nuk janë mbyllur. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është bllokuar nga presidenti. Kryeministri të vetmen punë që bënë është marrja e vendimeve jologjore për ta shpërdorur buxhetin e shtetit. Javën që shkoi, kryeministri, ministrat, zëvendësministrat dhe këshilltarët e tyre kanë marrë paga retroaktive deri në 15 mijë euro. Gjykatat janë

paralizuar për shkak të grevës së stafit administrativ, të cilët me të drejtë kërkojnë pagë më të lartë", ka thënë Hoti në konferencën e rregullt javore. Në këtë kontekst, ka përkrahur mjekët, minatorët dhe arsimtarët në kërkesat e tyre. "Minatorët e 'Trepçës' janë në grevë, sepse kryeministri me sejmënët e tij e ka përgatitur statutin që lë jashtë asetet e 'Trepçës' pa asnjë sqarim. Arsimtarët kanë paralajmëruar grevë. Mjekët me të drejtë kërkojnë paga më të larta. Lista e veteranëve është e papastruar, duke shpërdoruar miliona euro në muaj. Vizat nuk ka gjasat të hiqen për shkak të sinjaleve negative që po dërgojmë në Bruksel përmes aferave korruptive të pandëshkuara", ka thënë Hoti.

Më tutje, ai ka folur edhe për

dialogun me Serbinë, duke thënë se presidenti Hashim Thaçi, pas asnjë autorizim dhe ende pa nisur mirë dialogu me Serbinë i ka hequr të gjitha vijat e kuqe. "Për Lidhjen Demokratike të Kosovës shtetësia e Kosovës ka marrë zgjidhje përfundimtare gjatë procesit të Vjenës, ka marrë

formë me Deklaratën e Pavarësisë dhe ka marrë legjitimitet ndërkombëtar me opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Kjo qasje është e rrezikshme dhe e dëmton pozicionin ndërkombëtar të Kosovës. Presidenti nuk ka kompetenca kushtetuese dhe legjitimitet

politik për ta udhëhequr dialogun", ka deklaruar Hoti. Ai ka thënë se për LDK-në vijat e kuqe në dialog me Serbinë janë: integriteti territorial i Kosovës, karakteri unitar i shtetit dhe respektimi i frymës së Kushtetutës të Republikës të Kosovës në marrëveshjen që arrihet.

Kuvendi zgjedh tre gjyqtarët e Kushtetueses

Deputetët e Kuvendit të Kosovës në seancën e së premtes kanë zgjedhur tre anëtarët e Gjykatës Kushtetuese: Remzije Istrefi-Peci, Nexhmi Rexhepi dhe Safet Hoxha. Këta tre emra tashmë i kanë shkuar për dekretim presidentit Hashim Thaçi

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 6 KORRIK - Kuvendi i Republikës së Kosovës ka vazhduar edhe të premten punimet e seancës plenare. Në këtë seancë Kuvendi ka miratuar projektrezolutën për kontrollin e mërgimtarëve në kufi, e harmonizuar në mes të grupeve parlamentare, të cilin para deputetëve e ka paraqitur Faton Topalli.

Kuvendi në seancën e së premtes ka zgjedhur tre anëtarët e Gjykatës Kushtetuese: Remzije Istrefi-Peci (83 vota), Nexhmi Rexhepi (66 vota) dhe Safet Hoxha (62 vota), duke ia propozuar presidentit Hashim Thaçi për emërim.

Kryeparlamentari Kadri Veseli

dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë uruar për përzgjedhjen e tre gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Veseli gjykatësve të sapozgjedhur u ka uruar punë të mbarë dhe efektive në vazhdimin e traditës së mirë që ka krijuar Gjykata Kushtetuese. "Ndonëse shtet i ri, Kosova është dëshmuar shembulli më pozitiv, në rajon e më gjerë, i funksionimit të drejtësisë kushtetuese. Gjykatësve të sapozgjedhur u urojmë punë të mbarë dhe efektive në vazhdimin e traditës së mirë që ka krijuar Gjykata Kushtetuese, por edhe avancim të standardeve që kërkohen prej saj. Kjo merr rëndësi të veçantë, nga fakti se, nga sot, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, është një institucion tërësisht i koso-



varizuar, meqë më nuk do të ketë anëtarë ndërkombëtarë në përbërjen e saj", ka thënë Veseli. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se me

përzgjedhjen e tre gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Remzije Istrefi-Peci, Nexhmi Rexhepi dhe Safet Hoxha, Kuvendi përmbylli një proces të rëndë-

sishëm të sundimit të ligjit. "Tre gjyqtarëve të rinj u uroj punë të mbarë dhe integritet në mbrojtje të kushtetutshmërisë", ka deklaruar Haradinaj.



Holanda mbështet ngritjen e cilësisë së qumështit vendor në Kosovë

EPOKA E RE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 6 KORRIK - Përmes projektit "Programi për trajnime në sektorin e prodhimit të qumështit në Kosovë" synohet ngritja e kapaciteteve në industrinë prodhuese të qumështit. Promovimi i këtij projekti dyvjeçar është bërë sot, ndërkaq do të mbështetet nga Ambasada e Holandës në Kosovë dhe do të zbatohet nga Shoqata e

Prodhuesve të Qumështit të Kosovës dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara AERES të Holandës. Me këtë rast, zëvendësministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Mevludin Krasniqi, ka theksuar se ky projekt do të ndikojë në avancimin e mëtejshëm të sektorit të qumështit. Ai ka treguar se Ministria e Bujqësisë përmes politikave mbështetëse nga viti në vit po krijon klimë të favorshme për investime dhe zhvillim

të sektorit të qumështit. "Ministria e Bujqësisë edhe sivjet është duke e mbështetur sektorin e qumështit, ku përmes subvencionimit synojmë rritjen e fondit blegtoral dhe ngritjen e cilësisë së qumështit, ndërsa përmes granteve investive jemi duke investuar në ferma, në pajisje për avancimin teknologjik të përpunimit të qumështit dhe në shumë hapësira të tjera", ka thënë zëvendësministri Krasniqi. Ndërkaq ambasadorja e

Holandës në Kosovë, Gerrie Willems, ka thënë se projektet e tilla ndikojnë në avancimin e sektorit të qumështit. "Ky projekt ka rëndësi për industrinë e qumështit në Kosovë dhe duke ditur se Holanda ka një prodhimtari më të madhe të qumështit në botë, atëherë Holanda edhe duhet të jetë model për Kosovën. Për këtë arsye Qeveria e Holandës ka shprehur gatishmërinë e mbështetjes së këtij sektori në Kosovë që ndikon në

zhvillimin ekonomik të vendit", ka thënë ajo. Ndërsa kryetari i Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit, Milazim Berisha, ka treguar se në kuadër të këtij projekti do të bëhet një vlerësim i prodhimtarisë së qumështit dhe në bazë të analizave do të trajnohen një pjesë e stafit në një periudhë të caktuar në Holandë. Sipas tij, ky projekt do të ndikojë në ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve të sektorit të qumështit në vend.



Aeroporti i Prishtinës investon në sisteme të teknologjisë për procesimin e udhëtarëve

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Me qëllim të rritjes së efikasitetit në operime, mënjanimin të vonësave dhe rrjedhimisht rritjen e kënaqshmërisë së udhëtarëve, kompania "Limak" që menaxhon Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" tanimë ka implementuar sistemet më të avancuara për procesimin e udhëtarëve dhe të bagazheve të tyre. "Falë sistemit Altea të Amadeus për trajtimin në tokë dhe kontrollin në nisje (DCS) si

dhe sistemit të bazuar në 'cloud' për trajtimin e bagazheve (BRS), Aeroporti i Prishtinës ka reduktuar shpenzimet operacionale për 20 për qind vetëm gjatë dy muajve të fundit, e në të njëjtën kohë ka rritur performancën gjatë procesimit të udhëtarëve dhe trajtimit të aeroplanëve në tokë", është bërë me dije në komunikatën e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Më tej në këtë komunikatë

thuhet se me rritjen e numrit të udhëtarëve, krijimin e linjave të reja dhe duke dashur t'i tërheqin kompanitë ajrore, është me rëndësi thelbësore të zhvillohen operime të besueshme, të shpejta dhe me kosto efikase të mbështetura nga një platformë plotësisht e integruar e zgjidhjeve. "Kjo është arsyeja pse kemi zgjedhur këto sisteme të Amadeusit. Bashkëpunimi me Amadeusin na mbështet misionin tonë për të siguruar një mjedis

të qëndrueshëm dhe të sigurt, si dhe për ta rritur vazhdimisht cilësinë e shërbimeve tona ndaj udhëtarëve. Jam i kënaqur që falë këtyre zgjidhjeve, kostot tona operative po ulen dhe në të njëjtën kohë kemi rritur kënaqshmërinë e kompanive ajrore", citohet të ketë thënë drejtori i Operimeve në ANP "Adem Jashari", Gokmen Aritay. Ndërkaq udhëheqësi i IT EMA në Amadeus, Yannick Beunardeau, ka bërë me dije se janë të kënaqur

që një nga aeroportet më të suksesshme dhe inovative në Ballkan, i njohur për përsosmërinë e tij operacionale dhe përkushtimin ndaj shërbimeve të klientëve, ka miratuar zgjidhje të cilat më tej e përmirësojnë cilësinë dhe efikasitetin e operimeve kryesore të aeroportit. "Këto përmirësime tashmë po e ulin koston dhe mundësojnë një përvojë më pak stresuese për udhëtarët", ka deklaruar Beunardeau.

Banka Botërore aprovon projektin e ekonomisë digjitale për Kosovën

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 KORRIK - Bordi i drejtorëve ekzekutivë të Bankës Botërore (BB) ka miratuar të premtën Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE) për ta rritur qasjen e qytetarëve në shërbime më të mira dhe me shpejtësi të madhe (interneti) të brezit të gjerë frekuencor, si dhe në burimet e njohurive, shërbimet dhe tregjet e punës në internet. Huaja për këtë projekt kap shifrën 20 700 000 euro (e barasvlershme me 25 milionë dollarë). "Projekti do të ketë spektër të gjerë përfitimesh për popullin e Kosovës, duke e lidhur me informacione, shërbime dhe vende të punës.

Duke zhvilluar dhe forcuar infrastrukturën digjitale të Kosovës, ky projekt do t'i thellojë lidhjet e Kosovës me ekonominë globale, që është me rëndësi kritike për rritjen dhe zhvillimin në të gjithë vendin", citohet të ketë thënë në komunikatën e BB-së, menaxheri i Bankës Botërore për Kosovën, Marco Mantovanelli.

Kurse Natalija Gelvanovska-Garcia, udhëheqëse e ekipit të detyrës për këtë projekt, ka theksuar se projekti KODE ndërtohet mbi nismat kombëtare tashmë funksionale që janë zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë midis Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Botërore, si një sërë e pilotimeve të brezit të gjerë frekuencor në mjedise rurale të prira nga

Qeveria që shkrepin investime kapitale private në futjen në përdorim të brezit të gjerë frekuencor.

Ndërkaq Redon Begolli, bashkudhëheqës i ekipit të detyrës, ka thënë se projekti "Plus KODE" do t'i përshkallëzojë trajnimet për punë në internet, duke vënë në shënjestër të rinjtë e papunë ose të nënpunësuar me fokus te gratë, për të ndihmuar që t'u hapen dyert përfituesve për qasje në vende pune.

Në komunikatën e Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore theksohet se vetëm një numër i kufizuar i ekonomive familjare, bizneseve dhe institucioneve në Kosovë kanë qasje në brezin e gjerë frekuencor me

shpejtësi të madhe, që mund të ndihmojë në livrimin e shërbimeve publike, ofrimin e mundësive për fitimin e shkathtësive dhe gjenerimin e të ardhurave nëpërmjet punës në internet. "Shumë shkolla nuk kanë qasje në brezin e gjerë frekuencor, duke u mbështetur në vend të kësaj në lidhje të internetit me shpejtësi të ulët ose duke mbetur të palidhur, gjë që kufizon aftësinë e tyre për ta formuar kapitalin njerëzor që lypset për ekonominë e dijes. Tutje, universitetet dhe kolegjet në Kosovë janë të ndërlidhura shumë dobët, duke e bërë pothuajse të pamundur angazhimin në shkëmbimin e njohurive ose bashkëpunimin kërkimor me partnerët ndërkom-

bëtarë", është thënë në komunikatën për medie të BB-së, duke u shtuar se jo të gjitha qendrat shëndetësore janë të lidhura me infrastrukturën digjitale.

Në këtë komunikatë bëhet me dije se Kosova ka përfaquar transformimin digjital duke punuar për t'i plotësuar boshllëqet e infrastrukturës digjitale dhe për të zhvilluar kapital njerëzor konkurrues globalisht. Sipas kësaj komunikate, banorët e disa prej zonave rurale të mbështetura pamjaftueshëm, institucionet e kujdesit shëndetësor dhe shkollat fillore dhe të mesme do të përfitojnë nga projekti përmes qasjes në internet të brezit të gjerë frekuencor me shpejtësi të madhe dhe nisma për vetëdijësim digjital.

Gërxfhaliu, një ndër laureatët e çmimit të vitit në Sarajevë

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Në Sarajevë, në kuadër të samitit të menaxherëve më të suksesshëm të rajonit dhe Evropës, tre përfaqësuesit nga Kosova u gjetën ndër laureatët e çmimeve të vitit. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin personalitete të shumta evropiane të politikës, ekonomisë, artit, kulturës etj. Kështu, në kategorinë e menaxherit evropian të vitit për asociacionet e biznesit

është shpërblyer kryetari i OEK-ut, Safet Gërxfhaliu, që është një mirënjohje e kategorisë më të lartë që ndan ky asociacion dhe në të cilën sot u gjenden edhe kryeministrat e Bullgarisë dhe Maqedonisë, Bojko Borisov dhe Zoran Zaev. Me këtë rast u tha se çmimi ndahet për personalitetet që kanë shtyrë me sukses përpara procese me ndikim rajonal dhe më gjerë dhe kanë shërbyer si motivues

progresi.

Në kategorinë e menaxherit të dekadës është shpërblyer Njazi Musliu, drejtori i kompanisë "Eurometali", ndërkaq në kategorinë e menaxherit të kompanive më evropiane është shpërblyer Bedri Kasumi, drejtor i kompanisë "Vipa Pestova". Këto mirënjohje për Kosovën dhe ndërmarrësinë janë shumë me rëndësi dhe do të ndikojnë edhe në përmirësimin e imazhit të saj.



Veterani i UÇK-së bëhet me shtëpi të re

MALISHEVË, 6 KORRIK (ER) - Veterani i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Salih Hazrolli nga Banja e Malishevës, është bërë me shtëpi të re. Në ceremoninë e përrimit të shtëpisë për familjen e këtij veterani kanë marrë pjesë kryetar i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kryeari i OVL të UÇK-së, Hysni Gucati, kryetari i Degës së OVL të UÇK-së në Malishevë, Metush Kryeziu dhe veteranë e luftëtarë të UÇK-së nga Banja. Kryetari i OVL të UÇK-së, Hysni Gucati, ka thënë se e kanë për obligim të kujdesen për veteranët e UÇK-së. "Ne si shoqatë e kemi për obligim të kujdesemi për veteranët, duke përfshirë edhe sigurimin e strehimit apo

banimit për veteranët brenda mundësive që kemi si shoqatë. E falënderoj edhe Komunën e Malishevës për ndihmën e dhënë për ndërtimin e shtëpisë për këtë familje të veteranit, ndërsa familjes i uroj ta gëzojë shtëpinë e re", ka thënë Gucati.

Ndërsa kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, ka falënderuar iniciatorët për ndërtimin e shtëpisë për veteranin Hazrolli. "Shtëpia për veteranin e luftës së UÇK-së është ndërtuar në bashkëpunim dhe bashkëfinancim në mes të OVL të UÇK-së dhe Komunës së Malishevës. Shtëpia është e ndërtuar sipas standardeve, me hapësirë dhe kushte për banim dhe jetë normale", ka thënë Begaj.



Deçani nderon dëshmorët Ahmetxhekaj, Bajraktari dhe Mehmetaj

DEÇAN, 6 KORRIK (ER) - Komuna e Deçanit dhe Dega e Organizatës së Veteranëve të UÇK-së në këtë komunë kanë përkujtuar dëshmorët e kombit, Haki Ahmetxhekaj, Nimon Bajraktari dhe Bashkim Mehmetaj, me rastin e 20-vjetorit të rënies së

tyre. Në nderim të veprës së tyre, nënkryetari i Deçanit, Sami Cacaj, i cili ishte i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët, kolonel Abdyl Mushkolaj, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, FSK-ja, bashkëluftëtarë

të dëshmorëve, familjarë dhe qytetarë të shumtë, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurora me lule pranë varreve të Ahmetxhekajt, Bajraktarit dhe Mehmetajt në Kompleksin Memorial "Dëshmorët e Kombit" në Glllogjan.

Komuna e Mitrovicës e interesuar për zgjidhjen e kërkesave të qytetarëve



MITROVICË, 6 KORRIK (ER) - Në ambientet e Komunës së Mitrovicës është mbajtur takimi në të cilin është diskutuar për shqetësimet e qytetarëve të adresuara përmes platformës "ndreqe.com" si dhe veprimet e ndërmarra nga institucionet komunale. Pjesë e këtij takimi ishte komandanti i stacionit policor në jug, Ahmet Xhoshja, shefi i kabinetit të

kryetarit, Nehat Bahtiri, Fisnik Ibrahim nga Drejtoria për Infrastrukturë dhe Shërbime Publike, Irfan Peci nga Drejtoria e Mjedisit si dhe përfaqësuesit e platformës "Ndreqe.com", Jetmir Bakija dhe Hazir Isufi. Gjatë këtij takimi pjesëmarrësit janë pajtuar të zhvillohet një plan operativ për eliminimin e disa deponive ilegale përmirësimi i infrastrukturës rrugore në disa

lagje të qytetit, vendosja e tabelave të reja informuese dhe zgjidhja e disa ankesave të raportuara nga qytetarët në këtë platformë. Nga pjesëmarrësit e këtij takimi është kërkuar edhe vetëdijësim më i madh i qytetarëve lidhur me hedhjen e mbeturinave kur dihet se në tërë qytetin e Mitrovicës janë të instaluar kontejnerët për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme.

Fundjava me mot të ndryshueshëm

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka njoftuar se gjatë dy ditëve të fundjavës vendi ynë do të jetë nën ndikimin e masave të ajrit me presion të ulët atmosferik. Ky institut ka theksuar se si pasojë e këtyre kushteve moti do të jetë i ndryshueshëm dhe me stuhi të fuqishme lokale. "Në këto kushte, si pasojë e krijimit të vranësirave të dendura dhe jostabile dhe ndryshimit të masave termike në stade të ndryshme të

troposferës, do të mbajë mot i ndryshueshëm dhe me stuhi lokalisht të fuqishme. Stuhitë do ta përfshijnë pjesën veriore dhe verilindore të Serbisë duke e shtrirë veprimin edhe në pjesën verilindore dhe veriore të shtetit tonë, por me një fuqi më të dobët. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 22-26 gradë celsius. Do të fryjë erë nga drejtimi i verilindjes dhe veriperëndimit me shpejtësi mbi 16m/s", është thënë në njoftimin e IHMK-së.



Latifi: Shumë shpejt do të jetë funksional teatri i qytetit

Rahovec, 6 korrik (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur të premten në takim këshillin nismëtar për themelin e teatrit të qytetit në Rahovec, me anëtarët e të cilit

ka biseduar për përkrahjen institucionale dhe për hapat të cilët duhet të merren për themelimin e teatrit. Gjatë takimit kryetari Latifi anëtarëve të këshillit u ka premtuar

përkrahje institucionale. Ai ka thënë se Rahovecit i ka munguar teatri, por ka shprehur besimin se shumë shpejt ky teater do të jetë funksional, kurse përkrahja në këtë pikë

nuk do të mungojë. Bartës të të gjitha përgjegjësive për themelimin e teatrit janë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.



PROBLEME THEMELORE TË PUNIMEVE STUDIMORE (3)



Hajdin ABAZI

7. Hipotezat, karakteri i zakonshëm i tyre dhe si mund të formulohen ato?

Një çështje tjetër që lidhet me strukturën është ajo e përcaktimit të hipotezave të studimit. Ajo që më ka rënë në sy përgjithësisht është se hipotezat konceptohen si më të vështirat për t'u formuluar. Kam përshtypjen se zakonisht nuk dihet misioni i tyre, por as prej nga rrjedhin ato e as në çka do të duhej të çonin ato, përgjatë studimit.

Mendoj se ka një ngatëresë në atë se si konceptohet një hipotezë. Zakonisht, në terminologjinë më të përhapur, hipoteza konsiderohet si një e vërtetë e supozuar ose e hamendësuar. Një besim, një bindje, një vizion që mendohet i vërtetë, por që nga studimi pritet të tregohet se sa është i tillë apo jo. Këto janë zakonisht hipoteza të përgjithshme, ose teori të reja, të cilat kërkohet studim për të konstatuar statusin e saj. Këtë karakter nuk e kanë zakonisht punimet studimore nëpër universitete.

Në punimet që zakonisht nisen nga një "qëllim i studimit", hipotezat kanë karakterin e atyre që quhen "hipoteza pune", ose hipoteza praktike, për shkak se e orientojnë kahun e studimit, në mënyrë mjaft të qartë.

Por pikërisht kjo nuk është gjithëherë e qartë dhe shpesh shfaqen mangësi në formulimin e hipotezave. Këtu nuk do të flas për atë se zakonisht hipotezat formulohen me një gjuhë që më tepër shpreh konstatime se sa supozime (hipoteza). Do të theksoj faktin se shpesh hipotezat janë shumë të pakta, e çka është edhe më problematike - ndonjëherë formulohen si hipoteza të përgjithshme, ndërkohë që ajo duhet të jetë konkrete dhe madje disa sosh.

Shkaku i formulimit të hipotezave, në një strukturë që zakonisht vihet pas qëllimit, pas objektivave dhe pas pyetjeve studimore, është se ato shprehin besim se si pritet të jenë gjetjet e studimit, ose rezultatet e tij. Sigurisht se nuk ka një mënyrë të caktuar të formulimit të hipotezave si mënyrë e vetme adekuate, por më e thjeshta dhe më praktikja është të ndiqet linja e mësipërme - ajo e pyetjeve studimore.

Konkretisht, të jenë aq hipoteza

sa janë pyetje studimore dhe objektivat e studimit. Logjika është kjo: një hipotezë do të ishte përgjigje e hamendësuar e pyetjes përkatëse studimore, e kështu edhe tregues se si do të mund të përmbushet objektivi korrespondues. Duke qenë se më sipër u tha hipotetiki se do të formulohen pesë objektiva studimore dhe pesë pyetje studimore, atëherë edhe hipotezat do të ishte praktike të jenë pesë. Hipoteza e parë do t'i korrespondojë pyetjes së parë studimore dhe objektivit të parë studimor, e kështu me radhë secila hipotezë për secilën pyetje studimore dhe për secilin objektivi.

Këtu duhet tërhequr vëmendja se mund të ketë, fjala vjen, më shumë se një hipotezë për një pyetje studimore, sikurse që mund të ketë më shumë se një pyetje studimore për një objektivi. Kjo mund të bëhet atëherë kur një pyetje studimore nuk do të mund të përmblihte në vetë tërë objektivin përkatës, gjë që kërkohet edhe ndonjë nënpyetje shtesë për një objektivi; për mos t'u ngatërruar mundet të saktësohet pyetja e parë dhe një, dy apo më tepër nënpyetje të saja. E njëjta gjë mund të vlejë edhe për hipotezat. Po qe se një hipotezë e vetme nuk do të mund t'i jepte përgjigje të hamendësuar pyetjes përkatëse, atëherë do të mund të formuloheshin dy apo më shumë hipoteza; edhe këtu, njëra mund të ishte hipoteza përkatëse kurse të tjerat të jenë si nën-hipoteza.

8. Hyrja e artikuluar mirë qartëson studimin

Të gjitha këto (titulli i temës, qëllimi, objektivat, pyetjet studimore dhe hipotezat) paraqesin, sikurse u tha, aspektin teorik të problemit studimor, tërësinë e tij dhe paraqesin strukturën dhe komponentët e ndryshëm si aspekte teorike.

Të gjitha këto që u thanë deri këtu shprehin kryesisht paqartësitë, vështirësitë dhe problemet që hasen gjithandej në punime të ndryshme studimore. Më vonë, kur të shqyrtohen problemet e "përfundimit", do të tregojë se si kjo strukturë e këtyllë, po të ndiqet, do të mundësojë dhe lehtësojë për të hartuar përmbylljen e një studimi, e cila paraqet një problem shumë serioz në praktikën e tashme universitare. Këtu dua të tregoj efektin që do të kishte një strukturë e tillë e hyrjes.

Studimet teori-bazuar janë të tilla që synim kryesor e kanë arritjen e qëllimit të shtruar të studimit. Sigurisht, arritja e qëllimit do të jetë dhe duhet të jetë ekskluzivisht rezultat i studimit, i gjetjeve si rrjedhojë e kërkimit shkencor.

Po qe se qëllimi përimitohet në mënyrë e duhur ashtu që të seg-

mentarizojë entitete kuptimore të qëllimit respektivisht objektiva të studimit, atëherë, duke ndjekur objektivat dhe në përputhje me to, do të ishte shumë e lehtë të formuloheshin pyetjet studimore dhe pastaj hipotezat, si përgjigje ndaj pyetjeve studimore, i tërë studimi do të kishte një rrjedhë logjike, shumë të orientuar dhe afërmendsh të frytdhënëse.

Një strukturë e këtyllë do të qartësojë fazën tjetër, atë të studimit konkret, dhe do ta bënte studimin mirë të përcaktuar dhe qartësisht të bazuar. Do të krijonte kondita që të mund të kontrollohej kahu i studimit dhe të mbahej fokusi, në realizimin e një studimi të thelluar.

Po ashtu, do të lehtësojë aq shumë edhe konkretizimin e hetimit dhe njohjen e gjetjeve dhe rezultateve studimore, kur do të arrihej në atë pjesë kur studimi do të duhej rrumbullakuar, përkatësisht të arrihej në përfundime si rrjedhojë e tërë studimit.

Ndaj sa më shumë punë dhe shqyrtim kritik për të formuluar sa më qartë hyrjen dhe strukturën e mësipërme në mënyrë të kalibruar, me një harmoni të ndërvarur të këtyre komponentëve, do të krijohet një koherencë e studimit. Nëse do të duket "humbje kohe" përcaktimi i duhur i strukturës së hyrjes, kompensimi do të vijë gjithsesi më pas, gjatë realizimit të studimit, për shkak se hyrja do të bëjë të evitohen shumë punë të tepërta që zakonisht vijnë si pasojë e paqartësive të formulimeve të strukturës së hyrjes.

II. ÇALIMI METODOLOGJIK

Kur më sipër fola për aspektin teorik të problemit studimor e lash qëllimisht jashtë, pa e përfshirë, aspektin metodologjik, për faktin se kjo ka një rëndësi themelore për një studim dhe meriton t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Tash do ta shqyrtoj këtë çështje.

Te punime të ndryshme studimore, zakonisht, te pjesa që quhet "hyrje" figuron një strukturë (një nënkapitull) që përcakton metodologjinë e studimit. Që kjo bëhet, gjithsesi, është mirë; por nuk është aspak mirë që kësaj nuk i kushtohet vëmendja e duhur dhe kjo pjesë, që është me rëndësi të madhe shkencore, bëhet disi shkel e shko. Ashtu sikurse formulohet metodologjia e studimit në pjesën më të madhe të punimeve paraqet një problem serioz e që ua lëndon karakterin studimor. E pra, aspekti metodologjik i problemit studimor është dimension i mënyrës, instrumenteve, teknikave dhe metodave që do të përdoren në realizimin e studimit, dhe ka karakter po aq shkencor sa edhe vetë formulimi i aspektit teorik të problemit studimor.

Shqyrtimin këtu do ta vatrëzohet, në

njërin anë, te hedhja dritë mbi karakterin e mangët të përcaktimit metodologjik dhe, në anën tjetër, tetë treguarit se duhet të kultivohet në të ardhmen, madje të thellohet e të zgjerohet, serioziteti i përcaktimit metodologjik si kusht që edhe punimet e pretenduara si studime të arrijnë standardet e bërjes shkencë të kohës sonë.

1. Metodologjia i jep punimit karakter shkencor

Që në fillim duhet theksuar se në përmasa tepër shqetësuese shprehet në punimet universitare fakti se pjesa thuajse që më pak i kushtohet rëndësi, e që bëhet disi si sa për sy e faqe, është aspekti metodologjik. Të rralla janë studimet që njëmend të kënaqin nga ky aspekt. Kjo pakujdesi metodologjike është e kuptueshme për shkrime refleksive, për parashtrime spekulative, mendime të lira; por nuk ka se si të kapërdihet kur është fjala për punime studimore që pretendojnë, ose të paktën e deklarojnë, se janë me karakter shkencor.

Studimi i shkaqeve të kësaj gjendjeje të tashme me siguri ka ndonjë vlerë në të kuptuarit historik, për të gjetur burimet, arsyet dhe rrethanat si ka ardhur deri te kjo gjendje. Por kjo nuk do të jetë objekt shqyrtimi këtu. Fokusi është të shtjellohet ajo se si është gjendja sot dhe çfarë do të duhej bërë, që të tejkalohet kjo gjendje, në kuptimin e tejkallimit cilësor, pra të një përmirësimi që do të na ofronte me standardet bashkëkohore të bërjes shkencë.

Ajo që mund të quhet përgjithësisht si karakteristikë është fakti se sa përkushtim i dobët i bëhet aspektit metodologjik të studimit. Standardi aktual i bërjes shkencë në botë është qartësia metodologjike, si e vetmja qasje për të çuar në gjetjen e të dhënave që kërkohen, të dhënave adekuate, reale, të mbështetura, referenca ekzistuese dhe në përputhje me studimin. Kjo qartësi metodologjike shprehet si në shtjellimin teorik ashtu edhe në zbatimin praktik. Duke lexuar studime të tilla, bëhet e qartë se i tërë shtjellimi, prej fillimit e deri në fund, nuk është tjetër vetëm se realizim metodologjik. Epistemologu i mirënjohur Imre Lakatos kishte të pohuar diçka të qëndrueshme për shkencën, kur teorinë e mëdha, të cilat ai i quante programe hulumtuese shkencore, i kishte identifikuar me metodologjinë (The Methodology of scientific research programmes, 1965). Kjo, në asnjë mënyrë nuk duhet kuptuar, sikur studimi shkencor qenka kthyer në një formalitet procedural, por se i tërë studimit përmbajtësish

zhvillohet mbështetur në rregulla, procedura dhe përcaktimeve të kaheve studimore, duke iu përmbajtur atyre me rreptësi shkencore.

Bazuar në këtë standard bashkëkohor të bërjes shkencë në botë ajo që mund të thuhet për mënyrën e bërjes shkencë tek ne është se ne çalojmë metodologjikisht. Ky çalim mund të karakterizohet si një defekt serioz, gjithsesi jo i pariparueshëm por i cili kërkon vëmendje për t'u kuruar mënyra e bërjes shkencë te ne.

2. Qartësia metodologjike kusht për bërje studime të mirëfillta

Këtu nuk do të merren parasysh rastet kur një punim studimor nuk thotë as edhe një fjalë të vetme për metodologjinë, sepse nuk ke çfarë të thuash - asaj i mungon tërësisht njëra prej parakushteve të një punimi për të qenë i realizuar sipas një metodologjie të caktuar. E pra, ka punime të tilla studimore, të cilat pretendojnë karakter shkencor. Por duke qenë qasje përgjithësisht e tejkaluar kjo, nuk meriton ndonjë vëmendje të posaçme.

Këtë vëmendje e meritojnë, me të drejtë, ato punime të cilat e marrin në konsideratë nevojën metodologjike dhe përpiqen të lënë gjurmë në atë drejtim. Kjo është një tregues i mirë, që shpreh një prirje se cilës duhet kushtuar vëmendje; si dhe paraqet një fije ndërgjegjësimit se një punim për të qenë me karakter shkencor duhet të ketë të përcaktuar edhe metodologjinë e realizimit.

Në shumicën e punimeve studimore që realizohen nëpër universitete, zakonisht, në pjesën e hyrjes figuron edhe një pjesë, një nëntitull që quhet "metodologjia", diku quhet "korniza metodologjike", ndonjëherë "aspekti metodologjik", "metodat e përdorura" etj. Sido që të jetë, kuptohet se është fjala për metodologjinë e realizimit të studimit, ose metodologjinë me të cilën do të realizohet studimi në fjalë.

Me gjithë mangësitë, e rëndësishme është se mëtimi për të shprehur metodologjinë e studimit shënon kuptimin e nevojës së bërjes shkencë në mënyrë më të avancuar dhe me mënyrën bashkëkohore, atë se pa qartësinë metodologjike nuk mund të bëhet studim i mirëfillt shkencor. (Vijon)

(Autori është prof. ass. dr. dhe ka ligjruar për shumë vite lëndët Shkrimi akademik dhe Metodologjia e hulumtimit shkencor)

Londra miraton një protestë me rastin e vizitës së Trumpit

LONDËR, 6 KORRIK - Kryebashkiaku i Londrës, Sadiq Khan, ka miratuar një kërkesë të protestuesve për të lëshuar një balonë gjigante që paraqet presidentin Donald

Trump si një fëmijë të veshur me pelena, gjatë vizitës së presidentit amerikan në kryeqytetin britanik javën e ardhshme. Balona gjashtë metra e gjatë do


të fluturojnë mbi Parlament për dy orë mëngjesin e të premtës së ardhshme gjatë protestës së planifikuar. Krijuesi i balonës, përdori një faqe në internet për të grum-

bulluar më shumë se 20 000 dollarë për ta krijuar imazhin. Gjatë vizitës treditore presidenti Trump do të takohet me Mbretëreshën Elizabetë dhe kryeministren Theresa May.



Sekretari Pompeo viziton Korenë e Veriut

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, është ngarkuar nga presidenti Donald Trump për të mbikëqyrur nëse Kimi po mban premtimin e bërë në samitin e muajit të kaluar në Singapor për çnuklearizimin e Gadishullit Korean. Kryediplomati i ShBA-së u takua të premten me zyrtarin e lartë të partisë në pushtet dhe ish-shefin e inteligjencës Kim Yong Chol



WASHINGTON, 6 KORRIK - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, i dha fund të premten ditës së parë të bisedimeve dyditëshe në Korenë e Veriut lidhur me çmontimin e programit të armëve bërthamore të Penianit. Takimet vijjnë ndërkohë që, sipas njoftimeve, zbulimi amerikan vlerëson se udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, vazhdon ta zhvillojë infrastrukturën për programin e tij bërthamor. Bisedimet rifillojnë sot (e shtunë).

Pompeo është ngarkuar nga presidenti Donald Trump për të mbikëqyrur nëse Kimi po mban premtimin e bërë në samitin e muajit të kaluar në Singapor për çnuklearizimin e Gadishullit Korean. Kryediplomati i ShBA-së u takua të premten me zyrtarin e lartë të partisë në pushtet dhe

ish-shefin e inteligjencës Kim Yong Chol. Kjo është vizita e tretë e Pompeo këtë vit në Korenë e Veriut.

Në marrëveshjen e Singaporit, e cila u vëzhgua nga shumë afër, Kimi pranoi të punojë për çnuklearizimin e plotë të Gadishullit Korean, por nuk u dhanë hollësi se si dhe kur mund të realizohej kjo. Pompeo shpreson ta nxisë Korenë e Veriut për të punuar drejt një afati kohor për t'i dhënë fund programit të saj bërthamor dhe të paraqesë hollësi se si mund të kryhet verifikimi. Por, agjencitë amerikane të lajmeve ditët e fundit kanë publikuar fotografi të asaj që

duket të jetë një zgjerim i objekteve bërthamore në Korenë e Veriut.

Presidenti Trump, megjithatë, ka vazhduar t'i reklamojë rezultatet e samitit edhe përballë skepticizmit të disa ligjvënësve amerikanë. Një ditë pas samitit, Trump deklaroi: "Të gjithë tani mund të ndihen shumë më të sigurt sesa ditën që unë mora detyrën. Nuk ka më kërcënim bërthamor nga Koreja e Veriut". Këtë javë Trumpi shkroi në "Twitter" se administrata e tij ka pasur "shumë biseda të mira" me koreano-veriorët mbi planin e tyre për t'u çnuklearizuar dhe se e gjithë Azia është e entuziazmuar. Ai tha, "po të mos kisha

qenë unë, tani do të ishim në luftë me Korenë e Veriut!"

Këshilltari i sigurimit kombëtar i Trumpit, John Bolton, thotë se Koreja e Veriut mund ta eliminojë arsenalin e saj bërthamor brenda një viti, por zyrtarë të tjerë të ShBA-së kanë thënë se shpresojnë që kjo të mund të arrihet deri në fund të mandatit të parë të presidentit Trump në Shtëpinë e Bardhë, në janar 2021.

Sung-Yoon Lee, profesor për studimet koreane në Universitetin Tufts, tha se fjala çnuklearizim nënkupton gjëra të ndryshme për ShBA-në dhe Korenë e Veriut. "Për Uashingtonin ajo ka lidhje

vetëm me Penianin, ndërsa Koreja e Veriut kërkon një Gadishull Korean pa armë bërthamore, edhe pse nuk ka shenja që Koreja e Jugut të ketë një arsenal bërthamor", tha Lee. Ai tha se marrëdhëniet midis ShBA-së dhe Koresë së Veriut kanë ndryshuar dramatikisht në favor të Koresë së Veriut gjatë disa muajve të fundit. Lee tha se zgjerimi i infrastrukturës bërthamore të udhëheqësit Kim Jong Un, që nga samiti i Singaporit, është pikërisht ajo që Koreja e Veriut ka bërë gjatë 25 vjetëve të fundit, pra premtime në këmbim të negociatave të zgjatura me shpresën e koncesioneve nga ShBA-ja.

Zaev: Referendumi për emrin mund të mbahet në shtator

SHKUP, 6 KORRIK - "Referendumi do të mbahet më 23 shtator, 30 shtator ose 7 tetor dhe qëllimi është që deri më 15 janar të përfundojnë të gjitha detyrimet e parapara", tha kryeministri Zoran Zaev në një intervistë për televizionin shtetëror grek "ERT". Ai shtoi se referendumi do të ketë karakter të detyrueshëm, do të pranohet nga të gjithë, madje edhe nga

presidenti Ivanov.

Duke iu përgjigjur në pyetjen lidhur me afatet për palën e Maqedonisë, Zaevi tha se synimi që është vendosur është 15 janari. "Me referendumin e suksesshëm unë jam i bindur se të gjithë në Parlament do ta dëgjojnë popullin atë që do të thotë në referendum. Sot kam marrë një mesazh edhe nga presidenti Gjorge Ivanov, i cili

tha se, nëse referendumi është i suksesshëm, ai do ta mbështesë marrëveshjen me Greqinë", tha Zaevi, duke shtuar se ndryshimet kushtetuese pasuan pas referendimit, pas të cilit pritet që parlamenti grek ta ratifikojë marrëveshjen. Sipas Zaevit, pyetja e referendimit ka të jetë: "A jeni për në BE dhe NATO dhe a mbështesni marrëveshjen me Greqinë?"



Pak sociologji politike (njeriu ekonomik)



Nga Blerta HAXHIA

Politika na ndihmon të kuptojmë ide të caktuara në kontekste të caktuara. Posedimi i përgjigjeve të përgjithshme për pyetje rreth politikës megjithëse ato janë të vlefshme vetëm për momentin në shkencat politike fiton avantazhe të caktuara. Çështja mund të refuzojë të japë një vëllim të të dhënave që turmat duke e mbajtur atë të jenë të parëndësishme ose të tepërta. Në shkencat politike ndonjëherë ndodh që materialet që përdoren në kontekstin e saj janë të varfra me qëllimin për të qenë të pakufishme në kërkim të gjeneraliteteve. Politika sociologjike mundëson që t'i përdorim themelet sociale të politikës, të jepen një numër zgjidhjesh dhe ofron një kuptim thelbësor i të cilit është paraparak për studimin e mëtejshëm të sjelljeve politike, monitorim të institucioneve politike dhe revelon të drejtën publike. Lidhjet me të dhënat që ruhen në kategori të cilat janë intelektuale të dobishme dhe të aftë për të mbajtur mend, mund të ruhet kundër rreziqeve të njëanshmërisë, mallkimit i ngushtë të stërvitur dhe formalisht të preokupuar. Analiza e burimeve të sjelljes politike në kombinim me politikën, ekonominë sociale dhe faktorët ideologjik pasqyrohet në teorinë e famshme të Max Weberit ku relacioni i religjionit me ekonominë është i diskutuar. Ideja e 'njeriut ekonomik' aq kontravers dhe joshës është i eksploruar dhe i delimituar. Koncepti i elitës gjen materiale të reja për të zhvilluar dhe modifikuar përmes ekonomisë format qeverisëse brenda tre instancave: demokracia, aristokracia dhe tirania...

mirëpo qeveritë reale i kanë tejkaluar këto forma qeverisëse ku klasa politike merr emra të shumta dhe multiforme. Alternimi i demokratizimit të anëtarësimit i elitave në grupe të caktuara qeverisëse thërret efektin dakordues që njihet nga vetë populli. Pika më komplekse pa zhvilluar padrejtësi është metoda se si duhet ndjekur një lider. Në çdo hap filozofi, sociologu, ekonomiku, psikologu, e të tjerë inderdeterminojnë dhe rirforcojnë njëri-tjetrin. Aftësia për të menaxhuar materialet historike dhe sociologjike përmes fenomeneve kërkojnë një kulturë të pasur dhe realizem pa asnjë arrogancë. Roberto Michels qëndron si një besnik i idealeve demokratike ku ai shkruan se: "... demokracia e tanishme në histori përmbledh valet parardhëse. Ato thyhen në çdo pengesë. Ato duhet rinovohen. Spektri përfundimtar është i kurajuar vazhdimisht dhe në të njëjtën kohë i depresionuar. Kur demokracia ka fituar stadin të zhvillimit, ajo i nënshtrohet një transformimit gradual duke adoptuar shpirtin aristokrat dhe në shumë raste forma aristokratike kundër asaj që e lufton me shumë vrull. Tani akuzuesit e rinj ngrihen për të denoncuar këta tradhtarë, pas një kohe të artë luftimesh dhe pushteti i pamasë ata përfundojnë duke u përzier me klasën dominuese të vjetër. Sidoqoftë ata edhe njëherë janë të sulmuar nga kundërshtarë të rinj që apelojnë në emër të demokracisë. Kjo është e mundur nëse kjo lojë e egër vazhdon pa fund". Politika si një familje e madhe më konvergjenca e saj e bazuar mbi elementet që janë të shtrënguara nga e kaluara, kompozojnë familje të reja që njohin dhe respektojnë vlerat kulturës politike dhe janë rritur brenda gjirit të tyre. Teoria e Michels-it përkujton një nga vlerat e mira të James Madison ku të dy e shikuan procesin social si një kompeticion të vetë faktorëve të

interesuar rreth atij procesi. Padyshim që është e vërtetë merita e Marksit dhe Engelsit, që kanë qenë të parët jo vetëm që kanë ngritur një sistem me pjesë të veçanta ku forcat prodhuese kanë luajtur në procesin historik por gjithashtu kanë lënë firmën e tyre, aty me krijimin e një filozofie të re duke zënë vendin e tyre në shkencë. Këtë në fillim e bënë në manifestin komunist si një formë e vrazhde dhe vullnetshme duke thënë se historia botërore gjatë tërë zhvillimit të saj nuk është gjë tjetër veçse një luftë klasash dhe ai fenomen në rrafshin e aktivitetit e inkurajuar duhet kuptuar si një 'superstrukturë' e ndërtuar mbi baza ekonomike. Vilfredo Pareto, beson se materializmi historik ishte i aftë të bëjë një shërbim të shkëlqyer shkencës dhe vetë proletariatit. Duke u dakorduar me Pareto-n materializmi historik vesh elementet e jetës me një kriter aq sa kritik, shkencor dhe realist nga pikëpamja e ambicies të rrjedhës Darwiniane. Në raste të caktuara nuk dëshirohet kontestimi i vlerave të fatit, opinionëve dhe ndjenjave në zhvillimin e politikës dhe jetës njerëzore. Pareto i jep besueshmërinë Marksit për paraqitjen e parimeve të afirmuara ndërkohë që ato kanë qenë ide të ngatërruara dhe popullaritetin e teorisë historike duke e shpjeguar si fakt të domosdoshëm për njeriun. Me vëzhgimin e Benedetto Croce ndaj materializmit historik deprivon elementet e finalitetin të Utopisë ku socializmi marksis kërkon ta konvertojë duke mos i dhënë suport socializmit apo ndonjë mënyrë tjetër të jetës saj. Koncepti ekonomik historik është një doktrinë që shpjegon arsyet, gjenezën mirëpo nuk ndihmon socializmin që është një vizion pozitiv për të ardhmen. Heshtja e jashtme e luftës që përgjohet përmes historisë kërkon që materializmi historik të jetë i ballafaqueshëm me të vërtetën historike dhe të verifikojë

jë vendin e vet në shkencat politike. Teoria e materializmit historik na mëson se një grup social ka një sjellje të caktuar ndaj një rrethanë të caktuar duke u dakorduar me motivimin ekonomik. Duke u referuar si njeriu ekonomik nuk mund të themi se relacioni me ekonominë janë shpeshherë të komplikuar. Për ekonominë mënyra e jetës rrallë herë pranon të dallohet nga të tjerat dhe të qartësojë ndarjet nga rrugët tjera të jetës njerëzore. Përkatesia ndaj një grupi të caktuar social dhe pozicioni favorit që t'i përkasë një klase si race, kombi, shteti, religjioni, partia, familje, klubi apo nga shumë forma të paraqitura sociale që ndikojnë në mentalitetin dhe sjelljen e individit në formacionin heterogjen social të tij. Idealizmi me konsiderata e tij emfazon qartësinë se në jetën reale të abstraksionin absolut të njeriut ekonomik që sundohet nga rregullat ekonomike nuk ekziston. Njeriu nuk është një llogaritës ekonomik. Jeta e tij është një luftë e vazhdueshme përgjatë domosdoshmërive ekonomike, një shtresë ekonomike që i përket një sferë tradicionale e interesave e detyrave që ai duhet t'i përmbushë. Impulset që njeriu zotëron e shtynjë atë drejt shtresës materiale dhe pozitës sociale duke e divergjuar nga kursi ekonomik natyral për t'i dhënë aktivitetit të tij një drejtim utopik ekonomik. Njeriu ekonomik i ngritur nga natyra e tij fizike për Corradon Gini në fakt mbi baza të statistikave të shumta dhe të shumë konsideratave të prokreimi njerëzor shpjegon se "Se sa larg nga e vërteta është hipoteza e njeriut ekonomik, qëkur njeriu realisht mund të veproje si një njeriu ekonomik, kjo është ajo, mbi baza të fitimit të përlogaritës dhe jo të domimuar nga impulse ku numri i lindjeve duhet të reduktohet në masë". Njeriu është ekonomik në veprimet e tij dhe

gjendja e tij ekonomike është në mëshirën jo vetëm të ndikimit fizik të koeficientëve ekstra-ekonomik por edhe të stabilitetit të faktorëve ekonomik. Nëse baza ekonomike nuk determinohet në vetvete nga direktivat politik e sociologjik të kombit atëherë çfarë forme politike shtetërore determinon kursin e politikave ekonomike? Disiplinat ngulmuese të materializmit historik mund të thonë së gjeneza e shtetit edhe pse të krijuara nga asambltetë diplomatike apo në mënyrë spontane, asnjëherë nuk reduktohen vetëm në nevoja ekonomike. Mirëpo edhe pse kjo gjenezë është në kontrast me motivimin ekonomik na lejon që të shohim aspiratat ekonomike dhe dëshira për të përparuar ekonomisht. Dëshira për të pasur gjithnjë e më shumë klientë të mëdhenj brenda sferës ekonomike zhvillohet një tregti e madhe dhe një industri e fuqishme që paraqet domosdoshmërinë e ekspansionit të shteteve të vogla ekonomisht por nën tutelën e një konkurrencë të egër. Pjesa më e madhe më ndjenjën patriotike mbi mbetjet gjuhësore dhe aktivitete të imperativit kategorik ekonomik udhëhiqen nga ideja e nacionalizmit. Në luftërat moderne ku motivi ekonomik vepron dukshëm akoma veprojnë mbi faktorë të tjerë si sentimentalizmi i masave moderne edhe pse impulset ekonomike janë aty si shtytës primarë. Vlerat edukative të tendencave për të qenë sa më shumë një njeri ekonomik në vete për vetvete vlen për ta bërë sidoqoftë në shpinë të kapitalit dhe jo si një objekt në vete. Kapitali si lëvizje shoqërore, aktivizimin e saj e kërkon përmes anëtarëve që janë pjesëmarrës, pra të gjithë janë pjesë e kapitalit dhe aktivizimi i tyre bën që kapitali të aktivizohet. Dikush pak, dikush shumë je pjesë e kapitalit. (Oiekonomia (gr. vjetër - si të të udhëhiqen punët shtëpiake - ekonomia)

Qeveria miraton konceptdokumentet e trashëgimisë kulturore, të drejtës së autorit dhe të drejtat e përafërta

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Në mbledhjen e Qeverisë mbajtur të premten ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka propozuar për miratim dy konceptdokumente: atë për trashëgiminë kulturore si dhe atë për ndërmjetësimin e kontesteve në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta. Ministri Gashi ka thënë se ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore mbetet prioritet i MKRS-së dhe i Qeverisë së Republikës së Kosovës. "Hartimi i konceptdokumentit për trashëgiminë kulturore është paraparë në planin vjetor të punës së

Qeverisë si dhe në kuadër të listës së konceptdokumenteve për vitin 2018. Mbrojtja dhe ruajtja e pronave, objekteve dhe vlerave të trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe përcaktimi i masave ligjore dhe teknike për inventarizim, hulumtim, dokumentim, përzgjedhje, konservim, restaurim, administrim, prezantim dhe promovim të trashëgimisë kulturore në pajtim me kartat, konventat dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare, është përcaktuar edhe në strategjinë kombëtare për trashëgiminë kulturore", ka thënë Gashi. Ai ka shtuar se aprovimi i këtij dokumenti hap



rrugë për të punuar për hartimin e ligjit të ri për trashëgimi kulturore si një nga prioritetet e MKRS-së për avancimin e kornizës ligjore të trashëgimisë kulturore

dhe përmbushje e obligimeve për anëtarësimin e Kosovës në UNESCO. Gjithashtu, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në

bashkëpunim edhe me palët e tjera të interesit ka hartuar koncept dokumentin për ndërmjetësimin e kontesteve në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta i cili për qëllim ka harmonizimin e këtij dokumenti me Ligjin Nr. 04/L-065, si dhe Ligjin Nr. 050/L-047 mbi plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtave të Përafërta. Aprovimi i këtij koncept dokumenti mundëson nismën për hartimin e Rregullores për Ndërmjetësimin e Kontesteve në fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta.

E rrallë

Bananet janë drejt zhdukjes

Një banane e egër që mund të jetë çelësi për ta ruajtur kulturën e frutit të ngrënshtëm është vënë në listën e zhdukjes nga bota. Ajo gjendet vetëm në Madagaskar, ku kanë mbetur vetëm pesë pemë të pjekura të bananeve të egra. Shkencëtarët thonë se bima duhet të ruhet pasi ajo mund ta ketë sekretin për të pasur sërish banane në të ardhmen.



FOTO E DITES



Dy balena të krijuara nga mbeturinat plastike në Romë të Italisë. /AP/

E jashtëzakonshme

Po hante një pjatë të shijshme, kafshohet keqas nga krijesa e detit

Një vajzë kineze ka filmuar veten duke ngrënë gaforre të gjallë në shtëpi. Në momentin që e kapi me shkopinj, specia mblodhi këmbët, por një pjesë u kap në buzë, duke i shkaktuar



dhimbje të mëdha. Pamjet janë shpërndarë në platformën kineze, Xigua Video. Nuk është e qartë se me çfarë po ushqehet vajza, por ka dyshime se është gaforre 'e dehur'.

BARSOLETA E DITËS



Pyet shoku shokun?
 - A e njih atë njeri?
 - Po, ai së shpejti martohet dhe do të bëhet milioner.
 - Pse çka po fiton me martesë?
 - Një milion probleme.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

“INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



Në ora 18:20

“FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

“ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

“LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Personat që keni pranë nuk do ta


kuptojnë gjendjen tuaj shpirtërore sot. Do të ndiheni disi të lënë mënjanë për këtë arsye.



DEMI

Nëse doni ta dini opinionin e të tjerëve

lidhur me një çështje të caktuar mjafton që të pyesni. Kështu mund të jeni më të qartë në të ardhmen.



BINJAKËT

Keni prituri mjaft kohë që një projekt i

caktuar të realizohet. Sot që ka ardhur dita jeni të qetë që do t'i shijoni frytet e punës tuaj.



GAFORRJA

Po hiqni dorë në mënyrë të moderuar

nga raporti me një person që pretendon shumë prej jush. Me kalimin e kohës do ta shihni që do të jeni më të qetë.



LUANI

Sot po hasni në vështirësi për të çuar

përpara një impenjim që jeni zotuar. Me kalimin e orëve do të filloni të hiqni dorë.



VI RGJËR ESHA

Ju habit mënyra se si janë në të

vërtetë disa persona të cilët nuk i kishit njohur deri më sot. Gjithsesi është gabimi juaj që ju keni besuar.



PESHORJA

Sot do të arrini të kaloni një provë të

vështirë në marrëdhënie me të tjerët dhe që keni kohë që po e shtyni.



AKREPI

Nuk duhet të mendoni në asnjë moment për

punën sot sepse gjithçka duhet t'i dedikohet familjes suaj dhe njerëzve që ju duan.



SHIGJETARI

Po ekzagjeroni disi me frikën

tuaja sepse nuk do t'ju lënë të shijoni deri në fund çastet e bukura që ju ofron dita.



BRICJAPI

Nëse e merrni me optimizëm

çdo impenjim tuajin gjërat do të shkojnë më së miri. Më shumë është çështje mendjeje sesa fizike.



UJORI

Keni lënë që koha të kalojë pa mbyllur

asgjë në praktikë, por do të rikuperoni në kohë dhe do të arrini të zgjidhni gjithçka brenda ditës.



PESHQIT

Sot është dita ideale për të takuar

njerëz të rinj dhe për të parë alternativa të reja në çdo fushë të jetës. Gjërat mund të kenë një zhvillim të papritur.

Jennifer Lopez nis pushimet me të dashurin



Ajo është një nga femrat më seksi në botë. Aktorja dhe këngëtarja e famshme Jennifer Lopez po qëndron në Bronx për pushime me të dashurin e saj, Alex Rodriguez. J. Lo është shfaqur

tejet seksi me bikini ngjyrë rozë teksa po qëndronte afër të dashurit. Në fotografinë e postuar në rrjetet sociale shkruan: "Janë këto momente të qeta që kanë shumë rëndësi".

Victoria Beckham shfaqet plot stil në Paris



Së fundmi ajo ka festuar përvjetorin me burrin e saj, futbollistin e famshëm David Beckham. Këto ditë është shfaqur plot stil gjatë paraqitjes së saj në Paris. Ylli i Spice Girl duket elegante, e veshur me rroba të bardha.

Victoria Beckham është shfaqur plot stil gjatë paraqitjes së saj në Paris. Ylli i Spice Girl duket elegante, e veshur me rroba të bardha.



E verdha 'ngjyrë xhelozie', por Meghan ndjell atë

Meghan Markle është dukur për mrekulli në paraqitjen e saj më të fundit në Londër këtë të enjte. Ajo kishte veshur një fustan me dizajn mjaft të thjeshtë dhe me ngjyrë të verdhë, e cila, edhe pse

njihet si "simbol i xhelozisë", është pikërisht Meghan ajo që ka ndjellë zilinë dhe xhelozinë e të tjerëve me bukurinë e saj. Përkrah saj, nuk mungoi edhe princi Harry me të cilin u kurorëzua dy muaj më parë.

Fansat kundër Gigit me Zayn



Gigi Hadid dhe Zayn Malik janë rikthyer bashkë dhe janë shumë të lumtur për këtë. Megjithatë, fansat e tyre nuk e kanë pritur mirë këtë ribashkim duke thënë se po i bëjnë marketing

njëri-tjetrit. Sipas tyre, këtë gjë e vërteton edhe fakti që Zayn nuk e ndjek në "Instagram" Gigin. Pas shumë supozimeve ka reaguar edhe supermodeluesja, duke thënë se "jo çdo gjë që shkruhet është e vërtetë".



Autor: GAZMEND MORINA	E ÇAKUT MË TË POSHTËM	NJË PREJ FIGURAVE STILITIKE	NGJYRË E FYTYRËS	NEVOJË FIZIOLOGJIKE	DY BASHKË-TINGËLLORE	EPOKA ERE	THEMELI	EPOSI	FRIKA PATOLOGJIKE NGA VDEKJA	BASHKËVENDËS I ODISEUT	KËMISHË E THJESHTË PREJ PËLHURE TË BARDHË
PLAK I RRËGJUAR NGA MENDTË						PREMTIM SOLEMN PËR TË QËNDRUAR BESNIK					
I PLOGËT						PANDJESI EKZEMPLAR I VETËM					
FUTBOLLIST I NJOHUR PORTUGEZ (MANCHESTER UNITED)					FABRIKAT E MEKANIZUARA AKTORI REXHEPI						
ISMET FERATI			HIT NGA "NRG BAND" FILLIMI I SERISHËM					"K" në mes të dy "A" BASHKËT.			
SJELLJE E NDRERSHME, NDRERSHMËRI (shq.)							KASOLLE E BARINJVE MJET PËR RRËSHQITJE (shq.)				
BISHË MALI (pashq.)					NJË E PANJOHUR NË MATEMATIKË BUJK			OTRANTO, SIENA			ENERGJIK
LECKAMAN, ZHELAN								BASHKËT. MIDËEST REGIONAL LEAGUE		BASHKËT. PERANDOR ROMAK	
EPOKA ERE	KËNGËTARI NË FOTO SHAQIRI	KARROCË E HAPUR ME KATËR RROTA E TËRHEQUR PREJ KUJAJSH	FILOZOF DHE MATEMATIKAN GREK	LLOJ PESHKU NJË KONTINENT	ZANORE JO I VJETËR	"IRLANDA" ZANORE		PAJISJA PËR DREJTIMIN E VETURËS TRUMÇAK			
PARADHËNIA						PERËNDI, ZOT REGJISORI KRYEZIU		FUTBOLLISTI ZHJEQI MËRËT E NDËRTUARA ME DËRRASA			
ARË E MBJELLË ME ORIZ						PASURI E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA I SULMUAR		LLOJ VEGLE MUZIKORE KËNGËTARI HOXHA			
ZYRTARIZIM I NJË TRAKTATI							RADIUM, SULFUR		ACADEMY OF MANAGEMENT KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE		
SHAJAK I HOLLË E I RRAHUR MIRË				BASHKËT.	"RADIO TELEVISIONI ITALIAN" RREGULL NË TË NGRËNË (shq.)		KLUB FUTBOLLI NË GREQI ZANORE		NAIM ISMAJLI NJË NGJYRË		
BATTLE ACADEMY GROUND				ZAKON LAJM (turq.)		BIMË E VENDEVE TË NXEHTA BANORE E NJË QYTETI NË SHQIPËRI				BASHKËT. TË TEL-EFONUARIT (pashq.)	
EPOKA ERE	EMËR MASHKULLI MYSLIMAN (shq.)	OHAJO, HAITI GRENLANDA			KULAÇE FUTBOLLISTI SPANJOLL SERGIO (R. MADRID)		LLOJ KAUCUKU I FORTË E ÇMPREHUR				MBIZOTËRIM (shq.)
BUJQËSORE						KËNGËTARJA FLAKA				ELIZA DUSHKU KËNGËTARJA ... FARA	
BASHKËT.		KRYEMURG ISH "MISS ALBANIA"				"T" pas dy "U"	BASHKËT. SHKRONJA XVIII	FUTBOLLISTI BRAZILIAN FELIPE BIMË SHUM-EVJEÇARE E VENDEVE TË LAGËSHTA			
ISLANDA, DANIMARKA			SOLISTJA ... BYTYQI NDESHJE			GRIMCË MË E IMËT E ÇDO ELEMENTI KIMIK KRYEQYTETI I ESTONISË		LAPS NË ÇFARË VENDI			
.....AKTIVE, PRAPAVERUESE					MJET I THJESHTË LUNDRIMI FORTESË			TITULLI QË MBANTE NË DISA VENDE MYSLIMANE KRYESUNDIMTARI SHEGA			
KRYEPROKURORJA E SHQIPËRISË ... RAMA				NUK KA (bised.) MA JEP		KËNGË DJEPI DY BASHKË-TINGËLLORE				OLIVER NEUVILLE	
EPOKA ERE	U ARRATISA DUKAT				KËNGËTARJA VEJSIU IVAN DAKUR			ADEM JASHARI DY ZANORE		NIKEL NOTË MUZIKORE	
SHKOMBËTARIZIM										VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE BASHKËT.	
SHKRIMTARI HAZIRI						PJESË MUZIKORE PËR TRE INSTRUMENTE				AKTORJA ME FAMË BOTËRORE MOORE	

Sëmundje apo stres? 10 simptomat që s'do t'i mendonit kurrë



Dhimbje koke, nauze dhe madje edhe kariesi janë disa nga mënyrat e mahnitshme që trupi ynë përdor për të manifestuar një gjendje të shqetësuar.

Dhimbje koke – Sipas Klinikës Mayo, dhimbja e kokës “nga tensioni”, e shkaktuar nga iritimet e përditshme (siç është trafiku ose problemi i punës), është treguesi i parë i vërtetë i stresit dhe mund të shoqërohet me simptoma të tjera, të tilla si mpiksja e muskujve dhe bluarja e dhëmbëve.

Këshilla: mënyra më e mirë për të trajtuar këtë lloj dhimbjeje koke është të përpiqeni të lehtësoni dhe menaxhoni stresin, por nëse dhimbja bëhet aq e padurueshme sa të ndikojë negativisht në jetën e përditshme, është mirë të kërkonit ndihmë nga një mjek.

Iritimet e lëkurës – E çuditshme, por e vërtetë: lëkura mund të jetë një barometër i shkëlqyer për të matur nivelin e ankthit. “Stresi mund të shkaktojë shfaqjen e skuqjeve, zakonisht në formën e njollave të kuqe, në stomak, mbrapa, krahë dhe fytyrë, – shpjegon psikologjia dhe fizioterapistja Elizabeta Lombardo në Ditën e Gruas – dhe duke mos ditur shkakun e saktë, shumë ekspertë besojnë se kjo varet nga

efektet negative të stresit në sistemin imunitar”.

Këshilla: frymëmarrja mund të ndihmojë në mbajtjen e skuqjeve të lëkurës ose në parandalimin e shfaqjes së tyre. Për të maksimizuar efektet e saj, bëni 5 deri në 10 frymëmarrje të thella në kohë të ndryshme të ditës.

Tensioni i muskujve – Dhimbja në qafë që zakonisht tenton t’u atribuohet orëve të gjata të shpenzuara para kompjuterit mund të jetë një simptomë e stresit që, duke vepruar negativisht në sistemin muskuloskeletal, shkakton kontraktime muskulore dhe spazma.

Këshilla: në rastin e tensioneve muskulore në lidhje me stresin, mund të jetë e dobishme të marrësh një seri frymëmarrjesh të thella, duke u fokusuar në relaksim të zonës së tensionuar dhe të dhimbshme.

Dridhja e syve – Në mjekësi ndjesia e “qepallës së dridhur” njihet si “blepharospasm”, një kusht që

është shpesh i përkohshëm, por ende i mërzitshëm, i cili për disa mund të shkaktohet nga tensioni emocional.

Këshilla: shikoni larg nga ajo që po bëni (edhe më shumë nëse punoni në kompjuter) të paktën çdo njëzet minuta dhe shikoni pamjen jashtë dritares, ose mbyllni sytë tuaj dhe kujtoni vendin tuaj të preferuar.

Kutikulat e shqyera – Torturimi i kutikulave ose thithja e thonjeve tuaj është një zakon nervor, me të cilin shumë njerëz – sidomos gratë – përpiqen të shpëpusin veten për të qenë në gjendje të kanalizojnë dhe të përballojnë stresin.

Këshilla: në vend që ta hiqni atë me duart tuaja, është e këshillueshme që të mbani një top anti-stres në sirtarin e tavolinës, me të cilin do të luani në momentet kur ankthi do të shfaqet, në mënyrë që “ta shtrydhni atë nga trupi juaj”, sugjeron Debbie Mandel, ekspert në palestër dhe kontroll stresi.

Kariesi – Përveç higjenes së dobët orale, kariesi mund të shkaktohet edhe nga stresi, veçanërisht nëse tentoni t’i bluanit dhëmbët gjatë ditës ose kur flini, një zakon që mund të

shkaktojë erozionin e smaltit.

Këshilla: përpiquni të përcillni ankthin në letër dhe stilolaps, ose të bëni një listë të problemeve, në mënyrë që t’i shihni ato të shkruara në të zezë dhe të bardhë dhe pastaj të shkruani zgjidhjet e mundshme. “Por nëse bluarja është në një fazë të rëndë, është mirë të shkosh te dentisti për një ndërhyrje”, rekomandon Mandeli përsëri.

Të përziera – Stresi mund të shqetësojë stomakun dhe të përziera janë pasojë e drejtpërdrejtë. Këshilla: një truk që sipas Mandelit punon për të mbajtur ankthin në gj, është që të lejoni rrjedhjen e ujit të ngrohtë mes gishtërinjve. Provojeni që ta besoni.

Apatia – Ndjenja e dobët dhe apatike mund të jetë shenjë e stresit. Sikur të mos mjaftonte, tensioni nervor gjithashtu mund të shkatërrojë cilësinë e gjumit, me rezultatin që pas zgjimit ju do të ndiheni edhe më të lodhur dhe nervoz.

Këshilla: parashikoni kohën kur shtrihen ose merrni një pushim gjysmë ore në pasditë, pa u ndier fajtoresh që e keni bërë.

Harresa – Stresi kronik mund të

zvogëlojë lehtësisht madhësinë e hipokampusit, i cili luan një rol kyç në kujtesën afatgjatë, duke shpjeguar paqartësi të rastit të tilla si një takim ose ku janë vendosur çelësat e shtëpisë. “Për fat të mirë, hulumtimi ka treguar gjithashtu se sapo të zvogëlohet niveli i stresit, hipokampusi kthehet në madhësinë normale”, thotë Dr. Lombardo.

Këshilla: për të mbajtur trurin tuaj aktiv dhe për ta mbrojtur nga ankthi nuk ka asgjë si aktiviteti fizik: mjafton edhe të bëni ndonjë shëtitje ose të ngjisni shkallët në këmbë.

Konfuzion – Nëse nuk arrini të vendosni për asgjë, – qofshin edhe të tilla se çfarë të gatujmë në darkë ose çfarë të veshim nesër në zyrë – faji mund të jetë ankthi, që shkakton zbehje dhe zvogëlon aftësinë për t’u përqendruar.

Këshilla: për të rivendosur vëmendjen, bëni vetëm pak stërvitje në ajër të hapur, në mënyrë që të pastroni idetë tuaja dhe të gjeni ritmin tuaj. Rrezet e diellit në fakt ndihmojnë trupin për lirimin e serotoninës dhe vitaminës D: e para përmirëson humorin, e dyta sistemin imunitar.

(gazeta-Shqip.com)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

RUSSIA - CROATIA

GG

SWEDEN - ENGLAND

2

LAHTI - FC INTER

1

Pasardhës i Vokrrit në krye të FFK-së, Ademi

Agim Ademi është pasardhës i Fadil Vokrrit në krye të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK). "Jam i vetëdijshëm që po e pasoj një figurë të jashtëzakonshme, një legjendë të futbollit mbarëkombëtar. Nuk do ta kem lehtë, por duke e parë përkrahjen tuaj, jam i bindur se bashkë me KE të FFK-së dhe juve së bashku do ta vazhdojmë rrugën e nisur", ka thënë Ademi

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 KORRIK - Agim Ademi është zgjedhur kryetar i ri i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK). Në Kuvendin e Jashtëzakonshëm të FFK-së, Ademi ishte kandidati i vetëm për të qenë pasardhës i legjendës Fadil Vokri në krye të futbollit të Kosovës, me këtë rast mori 58 vota për dhe asnjë kundër. Vendi i kreut të FFK-së mbeti vakant pas vdekjes së papritur të legjendës së futbollit

lit në Kosovë, Fadil Vokri, kurse Ademi do të jetë në krye të FFK-së deri në vitin 2020. Me rastin e zgjedhjes kryetar, Agim Ademi ka premtuar punë në mënyrë që të ngrehë sa më shumë futbollin e Kosovës. "Jam i vetëdijshëm që po e pasoj një figurë të jashtëzakonshme, një legjendë të futbollit mbarëkombëtar. Nuk do ta kem lehtë, por duke e parë përkrahjen tuaj, jam i bindur se bashkë me KE të FFK-së dhe juve së bashku do ta vazhdojmë rrugën e nisur. Zotohem se do

të punoj pa u ndalur dhe bashkërisht me ju do të jem në shërbim të zhvillimit të futbollit. Shpresoj shumë se së bashku do t'ia dalim dhe futbollin e Kosovës do ta çojmë atje ku e ka vendin. Do t'i përmbyll të gjitha projektet në të cilat kam qenë pjesëmarrës dhe do t'i nisim edhe shumë projekte të tjera në partneritet me UEFA-n e FIFA-n", ka thënë Ademi.

Të pranishëm në Kuvendin e FFK-së ishin edhe zyrtarët e lartë të UEFA-s, Servet



Yardimci, Denis Bastari e Thierry Favre, ai i FIFA-s, Bjorn Vassallo, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, sekretari i përgjithshëm i Federatës turke të Futbollit, Kadir Kardash, del-

egacioni i FShF-së, Lutfi Nuri, Ilir Shulku e Edvin Libohova, nënkryetari i Federatës së Futbollit të Maqedonisë, Muhamet Sejdiu, presidenti i KOK-ut, Besim Hasani.

Franca kualifikohet në gjysmëfinale të Botërorit

MOSKË, 6 KORRIK - Kombëtarja e Francës është kualifikuar në gjysmëfinale të Kupës së Botës "Rusi 2018". Francezët e mposhtën Uruguain me rezultat 2-0 dhe tash synojnë ta vazhdojnë rrugëtimin drejt trofeut. Mungesa e sulmuesit Edison Cavani është ndier për ekipin e Tabarezit. Pas rastit të pastër të humbur nga Kilyan Mbappe në minutën e 15-të, me goditjen e tij me kokë që ka shkuar mbi traversë, francezët kanë gjetur golin në goditjen e tyre të parë në kuadrantin e portës. Autor i golit ka qenë Varane, i cili ka fituar duelin ajror me mbrojtësit e Uruguait dhe ka dërguar topin atje ku Muslera nuk mund të arrinte dot pesë minuta para fundit të pjesës së parë. Mbrojtësi i Real Madridit është bërë edhe lojtari i parë francez që shënon një gol në çerekfinale të Kupës së



Botës që nga Thierry Henry në 2006-n kundër Brazilit. Reagimi i amerikanojugorëve ka ardhur në minutën e 44-t me një goditje të bukur me kokë të Caceres, por Lloris ka bërë një pritje më të bukur, duke ndalur topin ta kalonte vijën fatale. Goditja përfundimtar për Uruguain ka ardhur në minutën e 62-të, kur portieri Muslera ka bërë një gabim të pafalshëm dhe i ka dhu-

ruar golin e dytë, Francës pas një gjuajtje qendrore të Antoine Griezmann. Një avantazh që mund të ishte trefishuar në minutën e 73-të, kur goditja e Tolisso ka kaluar pak sipër traversës. Minutat e mbetura të takimit nuk kanë dhuruar më emocione, me Francën që ka arritur ta mbrojë pa probleme avantazhin dhe pa rrezikuar pothuajse në asnjë moment.

Sot kompletohen gjysmëfinalistët e Botërorit

MOSKË, 6 KORRIK - Sot (e shtunë) kompletohen katër skuadrat gjysmëfinaliste në këtë kampionat botëror. Nga ora 16:00 zhvillohet ndeshja në mes të Suedisë dhe Anglisë dhe të dyja këto reprezentacione e kërkojnë kualifikimin në gjysmëfinale. Anglezët llogariten favoritë në këtë ndeshje, pasi në radhët e veta kanë mjaft futbollistë cilësorë dhe paraqitjet në këtë eveniment ka qenë stabile. Në 1/8 e finales, Anglia e mposhti Uruguain pas ekzekutimit të penalltive, pasi koha e rregullt dhe vazhdimet përfunduan 1-1. Në anën tjetër, Suedia ka tejkaluar parashikimet, duke lënë fillimisht Italinë jashtë Botërorit e më pas edhe Gjermaninë dhe duke e mposhtur në grupe Meksikën.



Në 1/8 e finales suedezët e mposhtën Zvicrën e shqiptarëve me rezultat 1-0. Ndeshja tjetër çerekfinale zhvillohet nga ora 20:00 në mes të vendit organizator, Rusisë dhe Kroacisë. Kroatët me mjaft mund e eliminuan pas penalltive Danimarkën, derisa rusët tejkaluan parashikimet duke eliminuar Spanjën pas ekzekutimit të penalltive, sepse koha e rregullt dhe vazhdimet përfunduan 1-1.

TË SHTUNËN TAKOHEN:
16:00 SUEDI-ANGLI
20:00 RUSI-KROACI

UEFA lavdëron Dritën dhe Prishtinën

PRISHTINË, 6 KORRIK - Drita dhe Prishtina janë paraqitur mirë në garat ndërkombëtare dhe kjo është lavdëruar edhe nga UEFA. Kalkulatori i koeficienteve të UEFA-s që bën përlogaritjen e koeficienteve të

vendeve anëtare është befasuar nga skuadrat e Kosovës. Prishtina dhe Drita me kualifikimet e tyre kanë bërë që Kosova të ngjitet në vendin e 53-të të klasifikimit të shteteve në këtë ranglistë të UEFA-s, ku

Kosova startoi para dy vjetësh prej pozitës së 55-të. Triumfet e Prishtinës në Europa League dhe të Dritës në Ligën e Kampionëve, ku dy skuadrat tash do të luajnë në rrethin e parë të garave respek-

tive, ka bërë që Kosova për sezonin 2018/2019 të jetë në vendin e gjashtë të vendeve më të suksesshme në garat evropiane. "Rezultatet e ekipeve të Kosovës nuk duhet të nënvlerësohen. Drita dhe Prishtina

kanë avancuar në rrethin tjetër e Kosova shumë shpejt po lëviz nga pjesa e poshtme e llogaritjeve të koeficienteve për shtetet anëtare të UEFA-s", shkruan në një postim të UEFA-s në "Twitter".

Juve nuk e përjashton mundësinë e transferimit të Ronaldos

TORINO, 6 KORRIK - Skuadra e Juventusit ka dalë me një komunikatë zyrtare pas thashethemeve për transferimin e Cristiano Ronaldos në

Torino. Ka tre ditë që ylli portugez është në qendër të vëmendjes së medieve për një transferim të mundshëm në Serinë A. "Në lidhje me lajmet

e fundit të lëshuara nga mediet, Juventus Football Club e specifikon se gjatë afatit kalimtar të transferimeve, klubi vlerëson mundësi të

ndryshme në treg dhe mundësia e finalizimit të tyre do të bazohet në rregullat ligjore", thuhet në komunikatën e Juventusit.



Prishtina, probleme me vizat për ndeshjen e Evropa Ligës

PRISHTINË, 6 KORRIK - Klubi i Prishtinës ka njoftuar se është duke hasur në probleme me pajisjen e vizave për ndeshjen kualifikuese të Evropa Ligës që e zhvillon ndaj Fola Esch të Luksemburgut. Me kërkesë nga shteti i Luksemburgut, futbollistët e Prishtinës duhet të aplikojnë për vizë në Ambasadën e Zvicrës që është fajësuar për vonesat dhe rrezikimin e anulimit të ndeshjes shkak i vizave. "Fitorja e mbrëmshme, përveç kualifikimit historik, ka gëzuar loja e përkryer dhe rezultati i thellë. Por, ende pa u zgjuar mirë, ende pa e shijuar fitoren, klubi është dashur të aplikojë për viza në Ambasadën e Zvicrës të caktuar nga Luksemburgu. Por, Ambasada është duke shkaktuar probleme dhe skuadra rrezikon të mos jetë e kompletuar apo edhe t'i pamundësohet udhëtimi për Luksemburg", thuhet në reagimin e Prishtinës. "Është mëkat i madh, në vend që futbollistët të jenë duke e shijuar fitoren, përveçse duhet qëndruar nëpër ambasada, ata po përballeshin edhe me diskriminim, sidomos me lojtarët nga Kontinenti i Afrikës", thuhet në reagim. Futbollistët që kanë udhëtuar vitin e kaluar në



Suedi në ndeshjen me Norrköpingun dhe tash në Gjibraltar të pajisur me viza britanike dhe me dokumentacion të rregullt u thuhet të presin për verifikim më të hollësishëm që merr kohë, ndërsa skuadra udhëton të hënën. "Përndryshe, skuadra kishte të premtën seancë stërvitore nga ora 10:00, por që ishte e çregullt për shkak të aplikimit në ambasadë. Por, nga

nesër ekipi do të jetë komplet dhe mund të llogarisim edhe në Armend Thaqin e Leotrim Bekteshin, ku do të vazhdojnë përgatitjet intensive për raundin e parë të UEFA Evropa Ligës", thuhet në reagimin e Klubit të Prishtinës. Ndeshja me Fola Esche të Luksemburgut zhvillohet të mërkurën më 11 korrik nga ora 18:00.

Vetteli: Ferrari ka shumë potencial, duhet vijueshmëri në rezultate



BERLIN, 6 KORRIK - Sebastian Vetteli ka rimarrë kreun e renditjes së përgjithshme në Formula 1 pas vendit të tretë arritur në garën e fundit në Austri. Edhe pse ajo fundjavë nuk ishte shumë pozitive për Ferrarin dhe pilotin gjerman, i cili u penalizua me tre pozicione dhe bëri disa gabime në start, sërish "kokëkuqja" i ngjiti të dy pilotët në

podium. "Kjo makinë ka një potencial shumë të madh. Kjo situatë ishte edhe para një viti, por në fund nuk e kishim forcën për ta mundur Mercedesin. Ndaj, çelësi i suksesit do të jetë të dimë ta zhvillojmë më tej këtë potencial", ka thënë Vetteli. Kampionati këtë vit duket me shumë luhataje nga të gjithë pilotët, çfarë do të thotë se do të jetë i hapur

deri në fund. "Të gjithëve u takon ta gabojnë në Formula 1, edhe rivalët tanë gabojnë. Duhet të jemi të durueshëm dhe të përfitojmë nga momentet. Duhet ta shfrytëzojmë këtë potencial dhe të fitojmë sa më shumë", ka shtuar Vetteli në prag të garës së Çmimit të Madh të Britanisë që zhvillohet ditën e diel në pistën e Silverstones.

SHKURT

Gjilani transferon Halilin

KF Gjilani e ka transferuar të premtën futbollistin e krahut të majtë Armend Halili. Mbrojtësi në edicionin e kaluar ishte paraqitur për skuadrën nga KEK-u, që ishte ndër lojtarët kryesorë të kësaj skuadre drejt rrugës së inkuadrimin në Superligë.

Josa: Prishtina dhe Drita i shërbyen futbollit të Kosovës

Prishtina ka arritur një fitore jashtëzakonisht të madhe duke mposhtur FC European 5-0. Pas kësaj fitore historike, trajneri i Prishtinës, Mirel Josa, ka folur për ndeshjen. "Cilësia e lojës ishte më e mirë, duke marrë parasysh shumë faktorë. Nuk dua të justifikohem për ndeshjen e parë. E kam thënë që niveli i skuadrës duhet të ngrihet nga java në javë. Loja e ekipit po përmirësohet nga java në javë. Skuadra ishte në lojën e vet. Ne i shërbyem futbollit të Kosovës, ashtu si edhe Drita", ka thënë Josa.

Ibra: Suedia mund ta fitojë Kupën e Botës

Sulmuesi Zlatan Ibrahimoviçi është i bindur se kombëtarja e tij mund ta fitojë Kupën e Botës në Rusi. Ai ka thënë këtë pas sesionit të fundit të stërvitjes në Kaliforni, me Los Angeles Galaxy, duke shpjeguar se në këtë pikë të turneut mund të përparojnë ekipet që "dinë t'i menaxhojnë emocionet e tyre, gjë për të cilën Suedia spikat". "Unë me të vërtetë mendoj se Suedia mund të bëhet kampione bote, siç thashë para fillimit të turneut. Ajo mundi Meksikën, e cila ishte e fortë, pastaj Zvicrën, me një kombëtare të mirë. Dhe, mos harroni, ekziston një vend i tërë, që e mbështet atë. Suedezët janë krenarë për ekipin kombëtar dhe do të vazhdojnë të jenë pavarësisht se sa larg shkojnë", ka thënë Ibrahimoviçi.

PSG-ja javën tjetër prezanton Buffonin

Ish-kapiteni Juventusit, Gianluigi Buffon, karrierën pritet ta vazhdojë në skuadrën e PSG-së. Portieri 40-vjeçar, i cili ka luajtur 17 vjet me "Zonja e Vjetër", mendohet se javën e ardhshme do të zyrtarizojë gjithçka dhe do të prezantohet në mënyrë madhështore. Thuhet se kontrata e Buffonit me klubin francez do të jetë njëvjeçare.

Lovren: Kroacia, si Liverpooli, shkon deri në finale

Mbrojtësi Dejan Lovren e ka krahasuar kombëtaren e Kroacisë me skuadrën e Liverpoolit, e cila shkoi deri në finale të Ligës së Kampionëve. "Nuk janë të njëjtit futbollistë apo e njëjta taktikë, por është i njëjti shpirt brenda ekipit. Kroacia luan ndryshe nga Liverpooli, por mendësia që kemi është e ngjashme. Na është rritur në maksimum besimi te vetja dhe te shokët e skuadrës. Kjo na ndihmoi të shkonim në finalen e Ligës së Kampionëve dhe mund të na çojë në finalen e Kupës së Botës. Pjesa më e madhe e futbollistëve kroatë janë në kulmin e karrierës", ka thënë Lovren.



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" S.H.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Prishtina, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Ndërmarrja Hidroekonomike, Ibër-Lepenc S.H.A. - Prishtinë, publikon këtë

KONKURS Për plotësimin e këtyre pozitave

1. Këshilltar i Kryeshefit Ekzekutiv (1)

Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:

I punësuar do të kryej këto detyra të punës;

- Ndhmon Kryeshefin Ekzekutiv në organizimin e procesit të punës;
- Këshillon Kryeshefin Ekzekutiv në përgatitjen e Planeve të Biznesit;
- Këshillon Kryeshefin Ekzekutiv në implementimin e projekteve të parapara me Planin e Biznesit;
- Rekomandon dhe sygjeron Kryeshefin Ekzekutiv për veprimet që duhet ndërmarr për realizimin e sukseshëm të Planit të Biznesit;
- Jep këshilla profesionale Kryeshefit Ekzekutiv për çështje nga fusha e veprimtarisë së tij;
- I njëjti do të kryen edhe punë tjera të cilat i përgjigjen përgatitjes së tij profesionale dhe aftësive të fituara me punë, të kërkuara nga Kryeshefi;

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimin.

Kushtet:

- Diplomë Universitare;
- Shkathësi komunikuese dhe aftësi organizative të punës;
- Njohuri për punë në kompjuter (MS, Word, Excel etj.);
- Njohja e gjuhëve të huaja do të jetë përparësi;
- Përvoja e punës në menaxhim të biznesit, ose konsulencë së paku 5 vite.

Kërkesës t'i bashkangjiten:

- CV;
- Diplomën;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Dëshmitë për kualifikimet plotësuese;
- Ekstraktin e lindjes;
- Certifikata që nuk është nën hotime;
- Fotokopja e letër njoftimit;

2. Asistent/e Administrativ/e e Kryeshefit Ekzekutiv (1)

Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:

- Është përgjegjës për pranimin e palëve të KE, përkatësisht caktimin e terminëve të takimeve të KE me palët;
- Pranon postën dhe pas kontrollimit nga KE, bën shpërndarjen e të njëjtës;
- Mban evidencën dhe përkujtuesin e punëve dhe takimeve të KE;
- Pranon thirrje telefonike;
- Kujdeset për furnizim me kohë të materialit shpenzues;
- Mban evidencën e shpenzimeve të KE për reprezentacion brenda ndërmarrjes;
- Kujdeset për përgatitjen me kohë të materialeve të KE, si hartimi, përkthimi, shumëzimi, arkivimi, shpërndarja etj;
- Kujdeset për mirëmbajtjen përkatësisht kushtet higjieniko-teknike të zyrës së KE;
- Është përgjegjëse për përdorimin dhe pranimin e e-maileve zyrtar të Ndërmarrjes;
- Është personi si dhe pika e parë kontaktuese e kabinetit të KE me të gjitha njësitë punuese e në veçanti me njësinë e Ujmanit,
- Bën interpretimin e planit ditor të energjisë elektrike, në mes të kabinetit të KE, njësisë së Ujmanit dhe KEK-ut, për realizimin e energjisë elektrike dhe ujit në tërësi
- Për punën e saj i përgjigjet KE dhe Menaxherit të kabinetit;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së KE, të cilat për nga natyra i përkasin këtyre detyrave të punës

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimin.

Kushtet:

- Kandidati/ja duhet të ketë kryer shkollën e mesme;
- Ai/Ajo duhet të ketë shkathtësi të dëshmuar në administratë dhe njohuri të procedurave bashkëkohore të punës në zyre duke përfshirë edhe njohurinë për përpunimin e tekstit;
- Përvoja e punës, së paku 1 (një) vit;

Kërkesës t'i bashkangjiten:

- CV;
- Diplomën;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Dëshmitë për kualifikimet plotësuese;
- Ekstraktin e lindjes;
- Certifikata që nuk është nën hetime;
- Fotokopja e letër njoftimit;

Aplikacionet mund të merren në web-faqen zyrtare të Ndërmarrjes www.iber-lepenc.org.

Aplikacionet e plotësuar së bashku me kopje të dëshmimeve të kërkuara sipas konkursit dorëzohen në Drejtorinë Qëndrore të N.H., Ibër-Lepenc – Prishtinë ose përmes postës.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Me kandidatin e zgjedhur do të nënshkruhet Kontrata e punës pas sjelljes së certifikatës mjekësore.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► N.T.SH. "KOBIT-PC" me seli në Prishtinë, shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70527367 nr fiskal 600049888 si dhe certifikatat tjera.

► Bujar Pulaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Dëshmorët e Zhurit" Zhur.

► Rron Morina shpall te pavlefshme dëftesën e kl XI Gymnazium Loyola Prizren.

► Figen Bajmaku shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

► Vetin Kollukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHF "Heronjtë e Lumës" Vermicë.

► Ledione Çoçaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Gymnazium Loyola Prizren.

► Muhamet Muçaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

► Urgjentisht kërkoj një banës me qera për një person te huaj, Banesa duhet te jete jo shumë larg qendrës, mundësisht tek "Qafa" ose "Tophane" Duhet te ketë dy dhoma gjumi, te jete e mobiluar bukur. Çmimi deri 300 euro. Për info: Tel 049-472-770

► Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perllushi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër të Prapë teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtër. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045\699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

► Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

► Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 286/1
 Datë: 06.07.2018

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARR), në bazë të nenit 13 dhe 34 të Ligjit nr. 04/L-138 për Arsimit dhe Aftësimin Profesional, nenit 38 të Ligjit nr. 03/L/189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare nr. 72 / 25 qershor 2010), bënë ftesë për aplikim të ekspertëve të jashtëm sipas Marrëveshjes për shërbimet e veçanta, për t'u bashkuar me panelin e ekspertëve që ndërmarrin veprimtari profesionale në AAAPARR, për këtë shpallim:

Konkurs

Qëllimi: Ekspertët do të zhvillojnë:

- Udhëzues për lëndën "Bazat e udhëheqjes së grupit turistik", në profilin "Udhëheqës i grupit turistik", në drejtimin e Turizmit;
- Udhëzues për lëndën "Njohuri për automjete" për profilin "Automekanik", në drejtimin e Makinerisë;
- Udhëzues për praktik profesionale në profilet Metalpunues, Saldator, Dirigjimi kompjuterik i makinave dhe Operator të prodhimit, në drejtimin e Makinerisë;
- Udhëzues për lëndën "Teknologjia e instalimit të ngrohjes dhe klimatizimit" në profilin "Instalues i ngrohjes, ventilimit/kondicionimit të ajrit" në drejtimin Energji, Klimatizim dhe Mjedis;

Për angazhim të:

I. 2 (dy) ekspertë me kohëzgjatje prej dy (2) muajve për hartimin e udhëzuesit (doracakut) për lëndën "Bazat e udhëheqjes së grupit turistik", për profilet e drejtimit "Turizëm" me qëllim të sigurimit të cilësisë në shkolla për profilet e Arsimit dhe Aftësimin profesional në kuadër të shkollave partnere të AAAPARR-së,

II. 1 (një) ekspertë me kohëzgjatje prej një (1) muaj për hartimin e udhëzuesit (doracakut) për lëndën "Njohuri për automjete" për profilin "Automekanik", në drejtimin Makineri në kuadër të shkollave partnere të AAAPARR-së,

III. 1 (një) ekspertë me kohëzgjatje prej një (1) muaj për hartimin e një udhëzuesi për praktik profesionale për klasat e dhjeta për profilet Metalpunues, Saldator, Dirigjimi kompjuterik i makinave dhe Operator të prodhimit në drejtimin e Makinerisë,

IV. 2 (dy) ekspertë me kohëzgjatje prej një (1) muaj për hartimin e një udhëzuesi për lëndën "Teknologjia e instalimit të ngrohjes dhe klimatizimit" në profilin Instalues i ngrohjes, ventilimit/kondicionimit të ajrit në drejtimin Energji, klimatizim dhe Mjedis, në kuadër të shkollave partnere të AAAPARR-së

Ekspertët do të bashkëpunojnë me Agjencinë për Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARR) dhe do të zhvillojnë udhëzues dhe materiale mësimore për:

- Bazat e udhëheqjes së grupit turistik;
- Njohuri për automjete;
- Udhëzues për praktik profesionale;
- Teknologjia e instalimit të ngrohjes dhe klimatizimit

Përgjegjës ndaj: Agjencisë për Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur
 Vendi i punës: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë dhe aspektet organizative dhe kohore:

Bazuar në termat e referencës për këtë aktivitet dhe përshkrimin të përmbajtjes, ekspertët duhet të:

- Zhvillojnë udhëzuesit konform profileve që zbatohen në kuadër të shkollave partnere që janë në menaxhimin e AAAPARR-së,
- Zhvillojnë materialet mësimore konform profileve që zbatohen në kuadër të shkollave partnere që janë në menaxhimin e AAAPARR-së,
- AAAPARR merr përsipër postimin në web-faqen e agjencisë si dhe shtypjen dhe shpërndarjen e këtyre udhëzuesve dhe materialeve mësimore, me qëllim të lehtësimin të përdorimit nëpër shkollat profesionale.

Kualifikimet:

Ekspertët duhet të kenë diplomë universitare në lëmin përkatës dhe të kenë së paku tri vite përvojë të dokumentuar në arsim dhe në lëmin përkatës.

I. 2 (dy) ekspert me kohëzgjatje prej dy (2) muajve për hartimin e udhëzuesit (doracakut) për lëndën "Bazat e udhëheqjes së grupit turistik", për profilet e drejtimit "Turizëm" me qëllim të sigurimit të cilësisë në shkolla për profilet e Arsimit dhe Aftësimin profesional në kuadër të shkollave partnere të AAAPARR-së,

Ekspertët do të bashkëpunojnë me Agjencinë për Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARR) dhe do të zhvillojnë këtë udhëzues i cili do të shërbejë si nxënësve, mësimdhënësve dhe instruktorëve të shkollave të nivelit parauniversitar, postuniversitar dhe kompanive – agjencie të ndryshme turistike në sigurimin e informacioneve të nevojshme për udhëheqjen dhe menaxhimin e ngjarjeve turistike në mënyrën me të mirë të mundshme.

Përgjegjës ndaj: Agjencisë për Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur
 Vendi i punës: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë dhe aspektet organizative dhe kohore:

Bazuar në termat e referencës për këtë aktivitet dhe përshkrimin të përmbajtjes së

udhëzuesit, ekspertët duhet të:

Zhvillojnë materialin (udhëzuesin) dhe të mbajë trajnimet e nevojshme për mësimdhënësit e shkollave partnere që janë në menaxhimin e AAAPARR-së. Materiali trajnuar (udhëzuesi) do të shërbejë shkollave për trajnimin e mësimdhënësve në një perspektivë më të gjatë të mësimin gjatë gjithë jetës.

Kualifikimet:

Ekspertët duhet të kenë diplomë universitare në lëmin përkatës, të ketë së paku 3 vite përvojë pune të dokumentuar në arsim dhe në lëmin përkatës.

II. 1 (një) ekspert me kohëzgjatje prej një (1) muaj për hartimin e udhëzuesit (doracakut) për lëndën "Njohuri për automjete" për profilin "Automekanik", në drejtimin Makineri në kuadër të shkollave partnere të AAAPARR-së.

Ekspertët do të bashkëpunojnë me Agjencinë për Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARR) dhe do të zhvillojnë këtë udhëzues i cili në kuadër të profilit të Automekanikes do të shërbejë instruktorëve, nxënësve dhe mësimdhënësve të shkollave të mesme të larta, si dhe punëtorëve të kompanive që e ushtrojnë këtë profesion.

Përgjegjës ndaj: Agjencisë për Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur
 Vendi i punës: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë dhe aspektet organizative dhe kohore:

Bazuar në termat e referencës për këtë aktivitet dhe përshkrimin të përmbajtjes së udhëzuesit, ekspertët duhet të:

Zhvillojnë materialin (udhëzuesin) dhe të mbajë trajnimet e nevojshme për mësimdhënësit e shkollave partnere që janë në menaxhimin e AAAPARR-së. Materiali trajnuar (udhëzuesi) do të shërbejë shkollave për trajnimin e mësimdhënësve në një perspektivë më të gjatë të mësimin gjatë gjithë jetës.

Kualifikimet:

Ekspertët duhet të kenë diplomë universitare në lëmin përkatës, të ketë së paku 3 vite përvojë pune të dokumentuar në arsim dhe në lëmin përkatës.

III. 1 (një) ekspertë me kohëzgjatje prej një (1) muaj për hartimin e një udhëzuesi për praktik profesionale për klasat e dhjeta për profilet Metalpunues, Saldator, Dirigjimi kompjuterik i makinave dhe Operator të prodhimit në drejtimin e Makinerisë në kuadër të shkollave partnere të AAAPARR-së.

Ekspertët do të bashkëpunojnë me Agjencinë për Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARR) dhe do të zhvillojnë udhëzues për praktik profesionale në profilet Metalpunues, Saldator, Dirigjimi kompjuterik i makinave dhe Operator të prodhimit në lëmin e Makinerisë.

Ky udhëzues mund të përdoret për automekanik, instalues të ngrohjes dhe klimatizimit, si dhe të ujësjellësit. Po ashtu mund të përdoret edhe nga punëtorët e ndërmarrjeve në lëmin e përpunimit të metaleve.

Përgjegjës ndaj: Agjencisë për Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur
 Vendi i punës: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë dhe aspektet organizative dhe kohore:

Bazuar në termat e referencës për këtë aktivitet dhe përshkrimin të përmbajtjes së materialit mësimor, ekspertët duhet të:

Zhvillojnë materialin (udhëzuesin) dhe të mbajë trajnimet e nevojshme për mësimdhënësit e shkollave partnere që janë në menaxhimin e AAAPARR-së. Materiali trajnuar (udhëzuesi) do të shërbejë shkollave për trajnimin e mësimdhënësve në një perspektivë më të gjatë të mësimin gjatë gjithë jetës.

Kualifikimet:

Ekspertët duhet të kenë diplomë universitare në lëmin përkatës, të ketë së paku 3 vite përvojë pune të dokumentuar në arsim dhe në lëmin përkatës.

IV. 2 (dy) ekspertë me kohëzgjatje prej një (1) muaj për hartimin e një udhëzuesi për "Teknologjia e instalimit të ngrohjes dhe klimatizimit" në profilin Instalues i ngrohjes, ventilimit/kondicionimit të ajrit në drejtimin Energji, klimatizim dhe Mjedis, në kuadër të shkollave partnere të AAAPARR-së

Ekspertët do të bashkëpunojnë me Agjencinë për Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARR) dhe do të zhvillojnë udhëzues për Teknologjinë e instalimit të ngrohjes dhe klimatizimit, në të cilin përfshihet shfrytëzimi i teknologjisë në modernizimin e ngrohjes qendrore i cili do të shërbejë instruktorëve, nxënësve dhe mësimdhënësve të shkollave të mesme të larta, si dhe punëtorëve të kompanive që e ushtrojnë këtë profesion.

Detyrat dhe përgjegjësitë dhe aspektet organizative dhe kohore:

Bazuar në termat e referencës për këtë aktivitet dhe përshkrimin të përmbajtjes së materialit mësimor, ekspertët duhet të:

Zhvillojnë materialin (udhëzuesin) dhe të mbajë trajnimet e nevojshme për mësimdhënësit e shkollave partnere që janë në menaxhimin e AAAPARR-së. Materiali trajnuar (udhëzuesi) do të shërbejë shkollave për trajnimin e mësimdhënësve në një perspektivë më të gjatë të mësimin gjatë gjithë jetës.

Kualifikimet:

Ekspertët duhet të kenë diplomë universitare në lëmin përkatës, të ketë së paku 3 vite përvojë pune të dokumentuar në arsim dhe në lëmin përkatës.

Inkurajohen të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kushtet, se CV-të dhe referencat, si dhe dëshmitë për kushtet e kërkuara t'i paraqesin në adresën:
 Ndërtesa MASH-T-II pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik- kati i III-të.Rr. Agim Ramadani p. n, Prishtinë. Ose E-mail: xhevahire.pllana@rks-gov.net, tel: 038- 200-20 351.

Afati i aplikimit: 8 ditë nga dita e shpalljes.

Për me shumë klikoni: <http://aaaparr.rks-gov.net/>



RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Prishtinë



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsimit / Department of Education

Nr. 445/2018
Dt. 05.07.2018

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Nenit 5 (shkronja c) të Ligjit për Arsimin në Komunat e Rep. së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 17 (shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Nenit 35 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar në Rep. e Kosovës Nr. 04/L-032, të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, të UA të MASHT 06/2015 si dhe në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore, Drejtoria Komunal e Arsimit në Skenderaj, shpall:

Konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2018/2019

Nr.	Niveli	Pozita	Institucioni	Vendi	Pensionim / Zëvendësim	Nr. i orëve	Nr. i pozita ve
1	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Pavarësia"	Baks	Vend i lirë	Normë e plotë	1
2	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Pavarësia"	Krasaliq	Vend i lirë	Normë e plotë	1
3	Shfmu	Mësimdhënës/e për Gjuhë angleze	"Pavarësia"	Krasaliq	Zëvendësim	20	1
4	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Abedin Rexha"	Turiqec	Vend i lirë	Normë e plotë	1
5	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Ismet Uka"	Ticë	Vend i lirë	Normë e plotë	2
6	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Migjeni"	Kllodernicë	Kohë të caktuar	Normë e plotë	1
7	Shfmu	Mësimdhënës/e për Gjuhë angleze	"Migjeni"	Kllodernicë	Vend i lirë	18	1
8	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Idriz Barani"	Terrnafc	Vend i lirë	Normë e plotë	1
9	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Shotë Galica"	Syriganë	Vend i lirë	Normë e plotë	2
10	Shfmu	Mësimdhënës/e për lëndën e Biologjisë	"Shotë Galica"	Runik	Kohë të caktuar	Normë e plotë	1
11	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Vëllezërit Frashëri"	Çubrel	Vend i lirë	Normë e plotë	4
12	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Vëllezërit Frashëri"	Kotorr	Vend i lirë	Normë e plotë	2
13	Shfmu	Mësimdhënës/e për Gjuhë angleze	"Vëllezërit Frashëri"	Çubrel	Zëvendësim	Normë e plotë	1
14	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Halit Geci"	Rakinicë	Vend i lirë	Normë e plotë	2
15	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Halit Geci"	Llaushë	Zëvendësim	Normë e plotë	1
16	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Faik Dragaj"	Paralelen e ndarë	Vend i lirë	Normë e plotë	1
17	Shfmu	Mësimdhënës/e për Gjuhë shqipe	"Faik Dragaj"	Leqinë	Pensionim	19	1
18	Shfmu	Mësimdhënës/e për Kimi - Biologji	"Faik Dragaj"	Leqinë	Vend i lirë	8 Biologji 6 Kimi	1
19	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Malush Ahmeti"	Rezallë	Vend i lirë	Normë e plotë	1
20	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Ahmet Delija"	Skenderaj	Zëvendësim	Normë e plotë	1
21	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Azem Bejta"	Prekaz i Epërm	Vend i lirë	Normë e plotë	5
22	Shfmu	Mësimdhënës/e për lëndën e Kimisë dhe Biologjisë	"Drenica"	Polac	Zëvendësim	18+2	1
23	Shfmu	Eduktor/e për parafillorë	"Halit Geci"	Rakinicë	Vendi i lirë	Normë e plotë	1
24	SHMT	Mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane	"Anton Çetta"	Skenderaj	Vend i lirë	15	1
25	Shfmu	Eduktor/e për parafillorë	"Bashkim Sadiku"	Tushilë	Vend i lirë	Normë e plotë	1
26	Gjimnazi	Mësimdhënës/e për Gjuhë angleze	"Hamëz Jashari" "Shaban Jashari"	Skenderaj	zëvendësim	3 + 10	1
27	Shfmu	Mësimdhënës/e për Edukatë muzikore	"Fehmi Rama" "Malush Ahmeti" "Elena Gjika" "Kuv. i Drenicës"	Likoc Rezallë Makërma Abri e Posht.	Vend i lirë	5 5 4 4	1
28	Shfmu	Mësimdhënës/e për Edukatë muzikore	"Halit Geci" "Enver Haliti" "Bashkim Sadiku"	Llaushë Lubovec Tushilë	Vend i lirë	8 4 4	1
29	Shfmu	Mësimdhënës/e për Kulturë figurative	"Drenica" "Halit Geci" "Enver Haliti" "Pavarësia"	Polac Llaushë Lubovec Krasaliq	Vend i lirë	4 4 4 4	1
30	Shfmu	Mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane	"Shotë Galica" "Vëllez. Frashëri" "Faik Dragaj" "Idriz Barani"	Runik Çubrel Leqinë Klinë e Epërme	Vend i lirë	6 2 2 5	1
31	Shfmu	Mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane	"Abedin Rexha" "Migjeni" "Skënder Skënderi" "Ismet Rrahmani" "Bashim Sadiku"	Turiqec Kllodernicë Vajnikë Aqarevë Tushilë Llaushë	Vend i lirë	7 2 2 2 2	1

			"Halit Geci"			4	
32	Shfmu	Mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane	"Azem Bejta" "Ilir Lushtaku" "Ahmet Delija" "Dëshm. e Qyqavicës" "Pavarësia"	Prekaz i Epërm Prekaz i Posht. Skenderaj Qirez Krasaliq	Vend i lirë	4 2 3 4 2	1
33	Shfmu	Mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane	"Drenica" "Malush Ahmeti" "Elena Gjika" "Ismet Uka" "Fehmi Rama" "Kuv. i Drenicës"	Polac Rezallë Makërma Ticë Likoc Abri e Posht.	Vend i lirë	6 2 2 2 2 2	1
34							

Kushtet: Për të gjitha vendet e punës, në të tri nivelet (shkolla fillore, shkolla të mesme të ulëta dhe shkolla të mesme të larta) kandidatët duhet t'ia kenë të kryer fakultetin - drejtimi përkatës sipas Normativit 06/2015, ndërsa në mungesë të kuadrit të kualifikuar vijonë kandidatët e tjerë, të drejtimeve të përfaqëta, që i plotësojnë kushtet më së miri.
Zgjedhja e kandidatëve për mësimdhënës do të bëhet në bazë të nenit 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, UA 06/2015 si dhe në bazë të rezultateve të panel-intervistës, me shkrim dhe me gojë.
Testi me shkrim, për të gjithë kandidatët e konkursit do të mbahet më 17 gusht 2018, prej orës 10⁰⁰ në Qendrën e Kompetencës.
Për Intervistën me gojë do të ftohën vetëm kandidatët e listës së ngushtë, sipas nenit 4 të UA 17/2009.
Emrat e kandidatëve dhe orari i intervistës do të publikohen në web faqen e Komunës së Skenderajt <https://kk.rks-gov.net/skenderaj/category/konkurscy-njollimel/>

Për konkurrim, kandidatët duhet të plotësojnë dokumentacionin:

- ❖ Diploma dhe një kopje e vërtetuar e diplomës;
- ❖ Kopja e letërnjoftimit;
- ❖ Verifikimin për punë nga gjykata;
- ❖ Certifikatën e gjendjes shëndetësore (në rast se pranoheni);
- ❖ Certifikatë trajnimi - nëse keni;
- ❖ Përvoja e punës - nëse keni;
- ❖ Referencën e punës - ata që kanë përvuajtë punë;
- ❖ Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës, kati i parë, sporteli nr. 1;
- ❖ Kandidatët mund të konkurrojnë më së shumti në dy shkolla;

Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomën e nostrifikuar nga MASHT.

Fillimi i punës për vendet e lartcekura, nuk do të jetë domosdoshmërisht me datë 03.09.2018, por varësisht nga vendi i punës në shkollë (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.

Rezultatet e konkursit do të shpallen në webfaqe të Komunës së Skenderajt me datë 31.08.2018.

Dokumentacioni nuk kthehet.

Afati i konkursit mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë dhe në webfaqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

Drejtoria Komonale e Arsimit
Skenderaj

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333